



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.07.2014, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e parë të politikës së zhvillimit për financat publike”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar”.
4. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
5. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Gent Strazimiri dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mark Frroku, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Fatmir Mediu dhe Keltis Kruja.

Të ftuar:

Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave

Milbana Treska – drejtoreshë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Gelardina Prodani – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Arjana Dymishi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Xhavit Curri – përfaqësues i Ministrisë së Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëmëngjesi!

Sipas kalendarit që kemi miratuar, sot do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e parë të politikës së zhvillimit për financat publike”, si dhe projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar”.

Për shqyrtimin e këtyre projektligjeve kanë ardhur zoti Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave, si dhe zonja Milbana Treska, drejtoreshë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave.

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Ju lutem, na bëni një përmbledhje të shkurtër të projektligjit, më pas do të dëgjojmë relatorin.

Erjon Luçi – Po i trajtoj të dyja projektligjet njëkohësisht.

Këto janë dy marrëveshje të nënshkruara me Bankën Botërore, që përbëjnë një rekord si në aspektin e shpejtësisë së plotësimit të reformave, të cilat mundësuan këtë marrëveshje, ashtu edhe në aspektin e shumës për të cilën bëhet fjalë. Domethënë, në

këto dy marrëveshje diskutohet për rreth 220 milionë dollarë, të cilat janë një rekord për mbështetjen buxhetore.

Norma e interesit për këtë shumë është jashtëzakonisht e butë, po flasim për normë interesi poshtë 2%-shit. Objekti kryesor i përdorimit të këtyre fondeve do të jetë pagesa e detyrimeve të prapambetura për të shmangur mbingarkesën e tregut të brendshëm, duke marrë borxh nga tregu i brendshëm dhe duke i lënë hapësirë tregut privat, që të marrë më shumë para nga tregu i brendshëm.

Ndërkohë, reforma kyçe në lidhje me forcimin e thesarit dhe të financave publike, që të mos lejohet krijimi i detyrimeve të prapambetura përsëri, është reforma e pensioneve, që së shpejti do të vijë në formën e një ligji; është përmirësimi i situatës në sektorin e energjisë, me uljen e disa pagesave të ndërmjetme midis sektorit publik dhe operatorëve në këtë fushë.

Për sa i përket marrëveshjes së dytë, objektivi kryesor ka qenë përmirësimi i procedurave për uljen e kredive të këqija, duke filluar me ndryshimin e rregulloreve të përmbartimit deri te procedurat e tjera për sa u përket atyre të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë për uljen e kredive të këqija.

Në aspektin ligjor kjo është një marrëveshje standarde, që ka qenë edhe më parë në parlament. Ka disa shtesa të vogla në aspektin e bordit të bankës, për të specifikuar disa gjëra, jo për Shqipërinë, por në aspektin e përgjithshëm si i trajtojnë ata. Për ne nuk ka ndonjë element që ndryshon shumë nga marrëveshjet e mëparshme, domethënë nga ato që kemi pasur me Bankën Botërore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Muçmata, si relator i këtij projektligji. Më pas do ta marrë fjalën zoti Peza për marrëveshjen tjetër.

Vexhi Muçmataj – Projektligji i paraqitur për shqyrtim vjen i propozuar nga Këshilli i Ministrave në bazë të nenit 81 të Kushtetutës. Qëllimi i këtij projektligji është akordimi i kësaj huaje, mbështetja e reformave për përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale të Shqipërisë nëpërmjet fuqizimit të menaxhimit të financave publike, trajtimi i detyrimeve të prapambetura, si dhe reforma në sektorin e taksave, pensioneve dhe energjisë, me qëllim mbështetjen e stabilitetit fiskal.

Nga pikëpamja ligjore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nga pikëpamja procedurale mbështetet në Rregulloren e Kuvendit, ndërsa nga pikëpamja e teknikës legjislativë nuk ka nevojë për ndryshime ose riformulime.

Në përfundim, ne e mbështesim këtë projektligj dhe propozojmë ta kalojmë në seancë plenare për shqyrtim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje për marrëveshjen e parë? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.07.2014, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Gent Strazimiri dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mark Frroku, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Fatmir Mediu dhe Keltis Kruja.

Të ftuar:

Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave

Milbana Treska – drejtoreshë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Gelardina Prodani – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Arjana Dyrmishi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Xhavit Curri – përfaqësues i Ministrisë së Financave

Fatmir Xhafaj - Kalojmë te marrëveshja e dytë, prezantimin dhe ekspozenë në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes e bëri zëvendësministri Luçi, kështu që kolegu Peza, në cilësinë e relatorit, do të bëjë një koment në mënyrë të përmbledhur.

Dashamir Peza – Hartimi i këtij projektligji vjen nga Këshilli i Ministrave. Marrëveshja në parim është miratuar në datën 3 prill të 2014-s dhe është nënshkruar nga qeveria në datën 30 maj të 2014-s. Sipas relacionit shoqërues të këtij projektligji, qëllimi i akordimit të kësaj huaje është mbështetja e reformës për forcimin e regjimit rregullator të mbikëqyrjes së sistemit financiar, si dhe zbutja e dobësive kryesore në sektorët financiarë, bankarë dhe jo bankarë.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, ndërsa në aspektin procedural ai paraqitet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kështu që ju ftoj ta votojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.

Faleminderit, zoti Luçi dhe zonja Treska, që ishit të pranishëm!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.07.2014, ora 09:10

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Gent Strazimiri dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mark Frroku, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Fatmir Mediu dhe Keltis Kruja.

Të ftuar:

Gelardina Prodani – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Arjana Dymishi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Xhavit Curri – përfaqësues i Ministrisë së Financave

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Nga Ministria e Financave kanë ardhur zonjat Gelardina Prodani, Arjana Dyrmishi, si dhe zoti Xhavit Curri.

Zoti Fino, në cilësinë e relatorit, më pas do të na bëjë një paraqitje të këtij projektligji.

Zonja Prodani do të na prezantojë projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Geraldina Prodani – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky projektligj vjen si rrjedhojë e implementimit të sistemit elektronik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Do të bëhet një shtesë në mënyrën e komunikimit ndërmjet administratës tatimore me tatimpaguesit, ku njihet si formë zyrtare edhe mesazhi elektronik. Data e dërgimit të mesazhit elektronik konsiderohet si data e marrjes së njoftimit për vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore drejtuar tatimpaguesit.

Risi tjetër e këtij projektligji është edhe ndryshimi që ai dallon ndërmjet regjistrimit të personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare. Konkretisht, për tatimpaguesit që e kanë për detyrim të regjistrohen paraprakisht në QKR, ky regjistrim shërben njëkohësisht edhe si regjistrim në administratën tatimore dhe në të gjitha skemat, si: skemën e sigurimit shoqëror, shëndetësor, të inspektoratit të punës dhe të organeve doganore. Nga ana tjetër, në kategorinë e tatimpaguesve të tjerë, që e kanë detyrimin të regjistrohen direkt në administratën tatimore, janë karakterizuar: organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit tatimorë, të vetëpunësuarit, ambulantët, si dhe kryefamiljari, që punëson individë si punëtorë shtëpie, kujdestarë etj.

Projektligji ka të bëjë edhe me shfuqizimin e një hapësire që kanë pasur OJF-të. Tani ky projektligj bën një unifikim, ku të gjithë tatimpaguesit janë të detyruar të deklarojnë në administratën tatimore çdo punonjës që fillon punë për herë të parë apo të punësuar rishtas të paktën një ditë kalendarike përpara se ky punonjës të paraqitet në punë. Ndërsa për të larguarit afati është brenda 10 ditëve.

Problem tjetër që ka pasur sistemi tatimor në Shqipëri ka qenë edhe procedura e çregjistrimit apo statusi aktiv ose pasiv i një subjekti. Me anë të këtij projektligji ne sugjerojmë që të kemi kalimin në mënyrë automatike nga sistemi të tatimpaguesve nga regjistri aktiv në pasiv. Nëse ushtrohet veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm, nuk dorëzohet deklarata tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muajsh në mënyrë të njëpasnjëshme, si dhe deklarohet në QKR pezullim veprimtarie tregtare. Siç e thashë, ky është një problem që e adresojmë në këtë projektligj, sepse *database*-n e kemi shumë të rënduar me subjekte, edhe pse rezultojnë aktive, në fakt janë pasive po të inspektosh bilancin e tyre.

Nga ana tjetër kemi procedurën e çregjistrimit. Edhe kjo është një çështje që tatimpaguesi shqiptar e ka vuajtur, duke u sorollatur nëpër zyrat e administratës shtetërore apo duke mos ditur se në çfarë statusi aktual është, edhe kur ka bërë kërkesën për çregjistrim nga ky sistem. Pikërisht me anë të këtij projektligji ne e rregullojmë këtë dhe mendojmë se data e çregjistrimit është data kur është marrë vendimi nga QKR-ja apo një vendim gjykatë. Në këtë mënyrë tatimpaguesi, i cili është person juridik, është i çregjistruar.

Në lidhje me tatimpaguesit që nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në QKR, ata çregjistrohen nga sistemi në momentin që kalojnë pasiv nga përfaqësuesit tatimorë.

Në lidhje me momentin e ndërprerjes së detyrimit për të deklaruarit, për personat fizikë apo juridikë, që kërkojnë të çregjistrohen, ky moment lidhet, ashtu si edhe mbyllja në të dyja statet, me çregjistrimin në QKR për personat juridikë dhe më pas me detyrimin apo mosnjohjen nga administrata tatimore për personat fizikë. Në momentin kur nuk kemi pamundësinë për dorëzimin në kohë të procedurave...

Fatmir Xhafaj – Këto që thoni janë të gjitha në relacion.

Geraldina Prodani – Kjo është procedurë, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Cila është procedurë, kjo që drejtoj unë apo ajo që thoni ju?

Geraldina Prodani – Këto janë procedurë.

Fatmir Xhafaj – Këto janë në relacion, nëse keni ndonjë gjë jashtë relacionit, mund të vazhdoni.

Geraldina Prodani – Gjithçka është e përfshirë në relacion.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, fjala është për ju, si relator i projektligjit.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” është programuar në kalendarin tonë trejavor. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Ky projektligj vjen si nismë e Këshillit të Ministrave dhe është hartuar nga Ministria e Financave. Baza kushtetuese e projektligjit është e saktë. Projektligjit nga studimi dhe relacioni shoqërues ka për qëllim të sjellë disa ndryshime procedurale dhe teknike, me qëllim vlerësimin e procedurave të tatimpaguesve në kuadër të lehtësirave që parashikon të ofrojë ky sistem i ri.

Unë nuk po ndalem në ndryshimet e 12 neneve të këtij projektligji, ato janë tashmë në relacion dhe në relatimin tim, të cilin të gjithë kolegët e kanë përpara dhe nuk dua t’ju ha shumë kohë duke i përsëritur.

Kur të bëjmë shqyrtimin nen për nen, bashkë me grupin e këshilltarëve kemi disa vërejtje për teknikën legjislativë. Në parim ky është një ligj i trajtuar saktë dhe duhet të kalojë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” .

Neni 1, që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 23 të ligjit ekzistues. Kush ka pyetje?

Bashkim Fino – Te pika 2 e nenit 1 vlerësimet, njoftimet, vendimet, komunikimet etj., pas fjalëve “të deklaruar nga vetë ai”, të shtohen edhe fjalët “në dosjen e tatimpaguesit”. Janë çështje të teknikës legjislativë, kështu që përfaqësuesi i qeverisë le t’i shikojë.

Fatmir Xhafaj – Përfaqësuesja e Ministrisë së Financave?

Gerladina Prodani – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Kolegët kanë gjë tjetër për këtë nen?

Urdhëroni!

Ermonela Felaj – Unë kam diçka për pikën 3 të nenit 1. Ju në projekt keni thënë se data e njoftimit të tatimpaguesit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimi të dokumentit nga shërbimi postar. Unë mendoj se ka shumë rëndësi përcaktimi i kohës se kur e merr njoftimin tatimpaguesi, sepse lidhet me afatet e ankimeve. Prandaj propozoj që ky afat të fillojë nga dita kur tatimpaguesi vihet në dijeni, që maksimalisht i takon 10 ditë nga dita kur ju i keni nisur mesazhin. Ka rëndësi dita kur ai merr dijeni, jo dita kur niset mesazhi. Çfarë kuptimi ka ndryshe kur ju thoni: “Konsiderohet njoftimi i marrë nga tatimpaguesi jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik apo të postës rekomande”? Ky parashikim nuk bën sens me parashikimin tjetër. Kështu që ju duhet të konsideroni si ditë të njoftimit ditën kur dërgoni mesazhin elektronikisht apo kur e nisni me postë. Në përgjithësi, edhe po të shohësh Kodin e Procedurës Penale apo Civile, këto lloj afatesh nisin nga dita kur ai merr dijeni.

Fatmir Xhafaj – Zoti Curri, keni fjalën.

Xhavit Curri – Qëllimi ka qenë që datë njoftimi të konsiderojmë datën kur mesazhi elektronik është nisur dhe datë të marrjes së këtij njoftimi të konsiderojmë 10 ditë pasi ai është nisur. Pra, kjo shkon me të njëjtën logjikë të postës rekomande.

Fatmir Xhafaj – Unë mund ta kem mbyllur postën elektronike ato 10 ditë dhe humbas të drejtën e ankimit. Ju thoni: “Pranimi i dokumenteve nga shërbimi postar”, shërbimi postar mund të jetë i papërgjegjshëm dhe e dërgon ditën e fundit.

Xhavit Curri – Prandaj janë lënë 10 ditë.

Fatmir Xhafaj – Ai e dërgon ditën e fundit të 10-ditëshit. Data e njoftimit është data e marrjes së mesazhit elektronik apo data e marrjes së dokumentit nga tatimpaguesi?

Xhavit Curri – Marrja e dokumentit është 10 ditë më pas.

Fatmir Xhafaj – Ky është afati 10-ditor, kështu që duhet ta sqarojmë.

Eduard Halimi – Unë gjykoj se i njëjti standard dhe e njëjta procedurë ndiqet edhe për njoftimet gjyqësore, ajo është e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile në fuqi bashkë me ndryshimet, që afati fillon 10 ditë nga marrja dijeni e tij edhe në rrugë elektronike, siç parashikohet në ligjin “Për komunikimet elektronike”, nga dita që ai ka marrë dijeni. Ai mund ta ketë pasur të mbyllur postën, telefonin apo *divize*-n me të cilin do të marrë njoftimin, por duhet të vërtetohet pikërisht dita kur ai ka marrë dijeni, sepse

nga ajo ditë fillon numërimi 10-ditor. Ky është standardi që është vendosur edhe në Kodin e Procedurës Civile. Të gjithë ata që sot do të jenë të pakënaqur do t'i drejtohen gjykatës, e cila do të ndjekë të njëjtin standard, atë që ka për komunikimet. Edhe njoftimet e gjykatave prej dy vjetësh bëhen edhe në mënyrë elektronike.

Fatmir Xhafaj – E kemi rregulluar në këtë komision këtë gjë, kështu që bie dakord me sugjerimet e kolegëve.

A jeni dakord me sugjerimin që bëri zoti Fino dhe me sugjerimet për njoftimin? Dakord.

Kush është dakord me nenin 1, me dy sugjerimet e bëra? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Bashkim Fino – Te neni 1 kemi bërë edhe një korrigjim të vogël, në pikën 3 fjala “aktet” të zëvendësohet me fjalën “dokumente” dhe të vihen “dokumentet e përcaktuara në pikën 2”, jo “në pikën 1”, sepse është bërë gabim.

Unë relacionin e kam depozituar tek të gjithë anëtarët e komisionit dhe në çdo nen kam bërë sugjerime. Kur të hidhet në votë, le të merret në konsideratë ose të rrëzohet sugjerimi im.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 2.

Eduard Halimi – Çfarë nënkuptoni me regjistrimin e të vetëpunësuarve dhe të fermerëve, që të gjithë fshatarët, edhe ata që punojnë tokën e tyre, do të regjistrohen dhe do të paguajnë tatime? Domethënë, te germa “dh” e pikës 2 të nenit 2 thuhet: “Do të regjistrohen tek organet tatimore fermerët dhe të vetëpunësuarit”. Ju po thoni se ata që punojnë tokën, mbjellin fasule për të mbajtur fëmijët me bukë duhet të regjistrohen, të quhen të punësuar dhe të paguajnë tatime?

Fatmir Xhafaj – Çfarë nënkuptoni me personat juridikë që nuk regjistrohen në QKR dhe duhet të regjistrohen në organet tatimore?

Xhavit Curri – Në lidhje me regjistrimin e fermerëve, ne po vendosim detyrimin që fermerët të pajisen me një nipt, me një numër identifikimi, në mënyrë që ato të kenë mundësi të përfitojnë nga skemat e rimbursimit për shitjet e produkteve bujqësore të tyre.

Pra, është një strategji që po punohet në lidhje me rimbursimin e fermerëve, të cilët shesin produkte në tregje të njohura për administratën tatimore. Pra, shesin për agro-industrinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është detyrim për të gjitha ata që duan të përfitojnë rimbursime.

Eduard Halimi – Pra, ky është detyrim, sepse ligji vendos detyrime, nuk e bën në mënyrë vullnetare, ai po të dojë shkon vetë. Ju po i detyroni njerëzit. Atë fermerin që mbjell domate dhe fasule për të mbajtur fëmijët me bukë ju po e detyroni që të shkojë të regjistrohet. Nëse është fakultative, ne ta vendosim që kush të dojë të shkojë të regjistrohet.

Fatmir Xhafaj – Zoti Curri, urdhëroni!

Xhavit Curri – Fermerët që duan të përfitojnë nga skemat e rimbursimit janë të detyruar të regjistrohen. Sigurisht, dikush që nuk ka ndërmend të përfitojë nga skemat e rimbursimit, nuk kërkon të marrë para nga shteti, absolutisht është i lirë të mos regjistrohet dhe të mos e marrë këtë nipt. Por kushdo që dëshiron të përfitojë nga skemat e rimbursimit është i detyruar të regjistrohet dhe të marrë nipt, në mënyrë që ai të mund të identifikohet dhe të lëshojë faturë për agro-biznesin apo për këto që ai tregton.

Eduard Halimi – Por për detyrimin e kryefamiljarëve që të deklarojnë punëtorët e shtëpisë, edhe ky është detyrim apo fakultative, sepse këta nuk kanë skemë rimbursimi?

Xhavit Curri – Ky detyrim ka qenë dhe është, ne thjesht jemi në kontekstin e pikës së ligjit.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje, sugjerime apo propozime për këtë nen?

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim?

Miratohet.

Bashkim Fino – Ti je kundër fermerëve që të mos marrin rimbursim.

Fatmir Xhafaj – Neni 3. Kush ka pyetje, sugjerime apo propozime?

Kush është dakord me nenin 3. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Bashkim Fino – Te pika 1 e nenit 4 propozoj që të hiqen fjalët “në rast se përmbushen të paktën një nga kushtet e mëposhtme” dhe pas fjalës “tatimore” të shtohen fjalët “në rastet e mëposhtme”.

Fatmir Xhafaj – Zonja Prodani, ju lutem!

Geraldina Prodani – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë gjë tjetër?

Kush është dakord, përfshi edhe sugjerimin e relatorit? Dakord. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5 “Çregjistrimi tatimor”.

Relatori e ka fjalën.

Bashkimi Fino – “Subjektet e regjistruara në organin tatimor çregjistrohen si më poshtë...”. Kjo është pjesa e riformuluar.

Fatmir Xhafaj – Ministria është dakord?

Geraldina Prodani – Dakord.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Te neni 5 për pikën 3 kam një pyetje: ju fusni një risi që Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata njofton organin kompetent tatimor për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim, jeni të sigurt që gjykata mund ta bëjë këtë me nismë, se nga përvoja e deritanishme procedurat për të...

Fatmir Xhafaj – Nuk është nismë, është në ligj kjo.

Vasilika Hysi – Po mund ta bëjë vetë. Mund ta bëjë gjykata një gjë të tillë, apo qytetarët do të vazhdojnë të shkojnë të kërkojnë dokumente nga një institucion te tjetri?

Fatmir Xhafaj – Te pika 3 e nenit 5.

Xhavit Curri - E njëjta procedurë që është ndjekur gjithmonë po ndiqet edhe tani. Thjesht kjo është riformuluar në mënyrë që të lehtësohet procedura e çregjistrimit të tatimpaguesve. Në fakt, tatimpaguesit që regjistrohen në gjykatë dhe nuk regjistrohen në QKR, por direkt në administratën tatimore, kanë të njëjtën procedurë siç e kishin prej shumë e shumë vitesh.

Pra, tatimpaguesi aplikon për t’u çregjistruar në gjykatë. Gjkata njofton brenda 30 ditëve administratën tatimore dhe nëse administrata tatimore nuk paraqet kundërshtim,

gjykata procedon me çregjistrimin e tatimpaguesit dhe nuk e çregjistron tatimpaguesin vetëm në rast se administrata tatimore e kundërshton çregjistrimin e tatimpaguesit. Pra, procedura është e njëjtë.

Fatmir Xhafaj - Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet neni 5 me vërejtjet e bëra, që janë pasqyruar edhe nga relatori.

Neni 6. Nuk ka vërejtje relatori. Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Neni 7.

Zonja Felaj e ka fjalën.

Ermonela Felaj – Pse është parashikuar që të shfuqizohet zgjatja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore?

Xhavit Curri - Në fakt, për një tatimpagues më rëndësishme se sa deklarimi, paraqitja e një letre, është në fakt pagesa e detyrimit tatimor dhe ne e konsideruam si pa sens faktin që i jepet e drejta tatimpaguesit që të shtyjë afatin e deklarimit, të paraqitjes së letrës, dhe ndërkohë për afatin e pagesës nuk i jepet kjo e drejtë për ta shtyrë një muaj. Pra për të shkuar në të njëjtën linjë si për deklarimin, sepse janë të lidhura shumë ngushtë, deklarimi me pagesën, dhe përderisa nuk ka lehtësi për pagesën, atëherë nuk ka pse ta ketë për të paraqitur një copë letër. Kjo është ideja: për të unifikuar procedurën lidhur me deklarimin dhe me pagesën.

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje të tjera?

Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Neni 8. Relatori është dakord. Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Neni 9. Ka ndonjë gjë ministria?

Xhavit Curri - Ideja është që për tatimpaguesit që nuk respektojnë detyrimin e tyre për të paraqitur deklaratën tatimore në një muaj të caktuar, administrata tatimore ka detyrimin ta kujtojë tatimpaguesin që nuk ka deklaruar dhe duhet të paraqesë deklaratën.

Dhe nëse pas dërgimit të kësaj letërkujtese, tatimpaguesi akoma vazhdon të jetë mosdeklarues, pra nuk e respekton detyrimin e tij, është parashikuar po në këtë nen, që administrata tatimore ka detyrimin për t'i bërë një vlerësim automatik nga zyra. Vlerësimi automatik bëhet me një nga format e njohura në legjislacion sot, që është një praktikë që ka gjetur qytetari.

Pandeli Majko – Këtë vlerësimin automatik, nuk e kuptoj.

Xhavit Curri – Vlerësim që e bën sistemi në bazë të historikut që sistemi ka në database. Nuk është në dorën e njerëzve, është në dorën e sistemit. Sistemi thotë: “Tatimpagues, ti nuk respektove detyrimin tënd për të deklaruar dhe paguar, atëherë sistemi e llogarit mbi bazën e disa metodave, të cilat janë unike për të gjithë tatimpaguesit”. Por filozofia e llogaritjes së këtij detyrimi është që ky detyrim nuk mund të apelohej. Pse? Sepse tatimpaguesi fare mirë mund të paraqesë deklaratën e tij qoftë edhe me zero dhe anulohet detyrimi që sistemi ka llogaritur për tatimpaguesin. Pra mjafton fakti që tatimpaguesi respekton detyrimin e tij për të paraqitur deklaratën dhe ky vlerësim elektronik automatik nga zyra anulohet.

Pikërisht për këtë arsye ne themi që është i paapelueshëm. Në kuptimin që sa t'i futet një procedure pa fund apelimi, ai paraqet deklaratën e tij dhe e bëri apelimin, e mbylli rastin.

Fatmir Xhafaj – Kjo letërkujtesa i dorëzohet në dorë?

I dorëzohet me postë?

(Specialisti përgjigjet pa mikrofon.)

Dakord.

Fjalën e ka zoti Majko.

Pandeli Majko – Kisha një ndërhyrje. Ky vlerësimi elektronik për mua lë shumë për të dëshiruar. Unë dje dhe sot kam lexuar median, për shembull, “Gazetën shqiptare” që thoshte “ një fjalëkryq është hyrë në server dhe janë pastruar të dhënat”. Nuk e di se sa qëndron kjo puna e vlerësimit automatik nëpërmjet elektronikës.

Xhavit Curri - Unë mendoj se është një hap i mirë cilësor përpara, që shkon në përputhje me praktikat më të mira. Unë e mirëkuptoj atë që ju thoni sigurinë, besimin, por sistemi i ri është shumë, shumë i besueshëm, shumë, shumë më i sigurt se sa sistemi i sotëm. Sistemi i sotëm nuk është se është 100% i sigurt, ka elemente të pasigurt, por

sistemi i ri është një sistem i kohëve të fundit, një teknologji shumë më e avancuar, mbi bazë web-i. Pra, sistem shumë-shumë më i sigurt se sa ai aktual. Por e rëndësishme është të kuptojmë që kjo është në përputhje me praktikën më të mirë që zbatohen në vendet e Bashkimit Europian.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Halimi.

Eduard Halimi – Unë kam një problem: ju thonë që vlerësimi tatimor do të bëhet automatikisht dhe ndaj këtij vlerësimi tatimor nuk do të ketë të drejtë apeli dhe ky do të mbledhet me forcë. Sistemi prodhon një letër, qenka i pagabueshëm sistemi, menaxhohet si menaxhohet ai serveri, është tjetër gjë, nuk po futemi aty, por ajo letër që na e nxjerr serveri i tatimeve qenka e paapelueshme. Si mund t'i hiqni të drejtën një tatimpaguesi për të apeluar vlerësimin tatimor? Kjo është e papranueshme.

Xhavit Curri – Me sa duket unë nuk arrita të shpjegojem shumë qartë.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë që të jemi të qartë, si e kuptoj unë, sepse unë jam në mbështetje të dispozitës që ka sjellë qeveria, sepse kam përshtypjes se është i ndryshëm nga ai që po trajtoni.

Këtu është fjala për ta kujtuar. I çon një letër dhe i thotë: “Zotëri, ti ke këtë detyrim”. Ai, minimalisht, është i detyruar të përgjigjet. Në qoftë se ai nuk përgjigjet, atëherë duhet të ndërhyhet organet tatimore. Në qoftë se ai përgjigjet dhe thotë: “Nuk e kam këtë detyrim tatimor, nuk e kam fare ose e kam kaq”, këtu procesi ndërpritet, vazhdon procedura e zakonshme.

Edhe që ai ta sfidojë organin tatimor dhe të thotë: “Nuk kthej përgjigje fare, bëjë çfarë të duash”, nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Afatet, thotë zonja Felaj.

Xhavit Curri – Afatet janë shumë konkrete, të njohura shumë mirë dhe të përshkruara në këtë ligj. Jo në kontekstin e këtij neni, por të ligjit. Janë dhjetë ditë nga momenti i afatit të deklarimit. Për shembull, nga data 14, në qoftë se do të marrim TVSH-në, duhet të kalojnë 10 ditë dhe në qoftë se tatimpaguesi brenda 10 ditëve nuk e paraqet deklaratën e tij, më 24 i lëshohet një letërkujtesë. Nëse pas 10 ditëve të tjera, tatimpaguesi vazhdon të mos e ketë paraqitur deklaratën e tij, i dërgohet ky njoftim vlerësimi automatik nga zyra dhe nga momenti që i dërgohet njoftim vlerësimi automatik

nga zyra, ky detyrim, në qoftë se tatimpaguesi vazhdon të mos deklarojë, konsiderohet si çdo detyrim tjetër dhe ka 30 ditë afat, që nuk është në këtë nen, por është në këtë ligj, për të filluar veprimet e mbledhjes me forcë të detyrimit, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos përgjigjet administratës tatimore.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje për pikën 2. Ju thoni që administrata tatimore brenda 10 ditëve lëshon një letërkujtesë. Pyetja ime është pak a shumë si pyetja që bëri zoti Xhafaj: letërkujtesa është në formë të shkruar apo edhe elektronike?

E dyta, çfarë vlere ka lëshimi i letërkujtesës, në rast se ju e filloni vlerësimin automatik dhe personi nuk ka të drejtë të ankohet kundër këtij vlerësimi automatik që bëhet. Pse e njoftoni, për të qenë në rregull që ju njoftova? Unë jam që për çdo njoftim i lëshuar, mund të jetë i drejtë apo jo, personi ka të drejtë të shprehet, përndryshe pse e njoftoni nëse e bëni automatikisht?

Xhavit Curri – Edhe një herë: letërkujtesa është thjesht për ta kujtuar tatimpaguesin që në datën 14 të çdo muaji duhet të kishte deklaruar. Nuk e paraqite deklaratën. Në datën 24 i çohet një letërkujtesë. Kjo letërkujtesë nuk ka lidhje me asnjë detyrim. Thjesht është një kujtesë: tatimpagues, paraqitu për të deklaruar, sepse kanë kaluar 10 ditë nga momenti që duhet të deklaroje.

Kjo bëhet në mënyrë elektronike në adresën e tatimpaguesit, sepse të gjithë tatimpaguesit deklarimin e kanë në mënyrë elektronike.

Pra, nëse tatimpaguesi, edhe pasi i ka kaluar afati 10-ditor, vazhdon të mos deklarojë, atëherë i çohet një njoftim tjetër, por ky njoftim nuk është më për ta kujtuar, se kujtesën e bëre, por për t'i thënë: “Ti duhet të paguash detyrim, unë e kam llogaritur me metoda alternative, ky është detyrimi që ti duhet të paguash”. Tatimpaguesi, nëse nuk është dakord me këtë, fare mirë ka të drejtën e zotit të paraqesë deklaratën e tij dhe ta bëjë zero këtë vlerësim automatik nga zyrat e administratës tatimore. Nëse ai nuk do ta bëjë këtë zero, atëherë ka pranuar, në një farë mënyre atë që unë i kam llogaritur me sistem.

Fatmir Xhafaj – Zonja Felaj e ka fjalën.

Ermonela Felaj – Për pikën 4 të nenit 9 të projektit, brenda sa kohësh pasi ka dalë njoftim vlerësimi automatik është i lejuar tatimpaguesi të paraqesë deklaratën e tij tatimore, e cila ju thoni se e anulon vlerësimin automatik?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me sugjerimet? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Neni 10. Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet me opozitën kundër.

Neni 11. Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Neni 12. Keni komente, sugjerime? Kush është dakord? Kundër? Abstenim.

Miratohet.

Jeni dakord në tërësi? Kundër? Opozita tre kundër.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.07.2014 ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”,

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Gent Strazimiri dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mark Frroku, Silva Caka, Arben Ristani, Edi Paloka, Fatmir Mediu dhe Keltis Kruja.

Të ftuar:

Gelardina Prodani – Ministria e Financave

Arjana Dyrmishi – Ministria e Financave

Khavit Curri – Ministria e Financave

Fatmir Xhafaj – Fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për sistemin e taksave vendore”.

Zonja Prodani, ju lutem, bëni një përmbledhje të shkurtër të projektligjit!

Geraldina Prodani – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ky projektligj, ashtu si projektligji i mëparshëm bën disa rregullime procedurale për t’i hapur rrugë implementimit të sistemit të ri informatik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ai vendos në vend një padrejtësi në lidhje me normat tatimore për biznesin e vogël. Më përpara ka qenë që biznesi i vogël, i cili kishte një xhiro vjetore 0 deri në 2 milionë lekë, paguante 25 mijë lekë tatimfitimi, ndërsa ai që ishte me xhiro nga 2 deri 8 milionë lekë paguante 7,5%, por mungonte një nivel dysHEME për të barazuar pikërisht të dyja llojet e bizneseve dhe me anë të këtij projektligji që ne propozojmë vendoset ky nivel. Domethënë, edhe bizneset të cilat kanë një xhiro vjetore nga 2 deri në 8 milionë mund të tatohen me 7,5%, por jo më pak se 25 mijë lekë. Kjo për të vendosur një drejtësi në sistem.

Nga ana tjetër, kemi mundësinë e llogaritjes proporcionale të tatimit fiks për tatimpaguesin me qarkullimin vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë si për momentin kur fillon në mes të vitit apo në një periudhë të caktuar të vitit apo edhe kur ai e ndërpret veprimtarinë në një periudhë e cila nuk është në përputhje me vitin kalendarik.

Një risi tjetër e këtij projektligji është afati kohor brenda të cilit duhet të paguhet detyrimi fiks për tatimpaguesit nga zero deri në 2 milionë lekë. Me anë të këtij projektligji përcaktohet data fikse kur duhet të bëhet kjo pagesë.

Pranohet nga organet tatimore edhe zvogëlimi i parapagimit në raste kur vërtetohet nga kjo administratë se tatimfitimi i thjeshtuar do të jetë në mënyrë domethënëse për periudhën pasardhëse më i ulët.

Diçka tjetër, e cila kërkohet nga implementimi i sistemit të ri, ka të bëjë pikërisht me atë për të dalluar biznesin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë. Duhet që ky biznes të paraqesë një deklaratë vjetore deri në datën 10 shkurt të vitit për t’u dalluar nga pjesa tjetër. Kjo është thjesht për t’u bërë në përputhje me sistemin. Është një kërkesë

që sistemi e do, është një deklaratë shumë e thjeshtë vetëm për identifikimin dhe evidentimin e këtij biznesi.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Përfaqësuesi i qeverisë ishte shumë i qartë. Ky projektligj ka ardhur thjesht për çështje llogaritjeje dhe për vendosje të një niveli dysHEMEJE. Ne e kemi thënë edhe në programin tonë qeveritar që nga 0 deri në 2 milionë do të paguhet tatim deri në 25 mijë lekë të vjetër. Nga 2 deri në 8 milionë do të paguhet 7,5% e saj. Mirëpo nga përlllogaritjet që ishin bërë ndonjëherë i binte që mund të paguante edhe më poshtë se 25 mijë lekë të rinj. Me këtë projektligj ne vendosim dysHEMENË, duke thënë që edhe biznesi nga 2 deri në 8 milionë do të paguajë 7,5%, por jo më pak se 25 mijë lekë të rinj.

Pjesa tjetër e neneve janë procedurë që nuk kanë ndonjë risi të veçantë.

Unë mendoj se ky projektligj duhet të kalojë dhe nuk kam asnjë vërejtje për paraqitjen që i është bërë nga Ministria e Financave dhe qeveria.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje?

Zonja Felaj e ka fjalën.

Ermonela Felaj – Unë kam një pyetje për pikën 2 të nenit 11 të projektit, aty ku parashikohet që tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë duhet të paguajnë një tatim fiks në masën 25 mijë lekë në vit. Di që ka pasur shumë kontestime nga tregtarët e vegjël, që deri tani janë trajtuar si ambulantë në njësi të ndryshme vendore. I njëjtë është edhe kontestimi që bënë tregtarët në Lezhë.

Çfarë keni marrë parasysh për t'i lehtësuar sado pak apo për t'i qartësuar personat që ushtrojnë biznes në këtë pikë, se shoh që ka ngelur po njëlloj?

Xhavit Curri – Ajo që është menduar që në paraqitjen e parë në dhjetor të këtij viti të ligjit “Për taksat vendore”, dhe vazhdon e njëjta ide, është që tatimpaguesit e vegjël, pra ata që kanë pak veprimtari, me xhiro shumë të vogël, të paguajnë një tatim fiks vjetor, 25 mijë lekë dhe poshtë 25 mijë lekëshit, unë mendoj se nuk mund të ketë biznes që mund të pretendojë të paguajë, duke e konsideruar si kufirin minimal të mundshëm të një pagese për të qenë tatimpagues.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Projektligji ka sjellë vetëm dyshemenë. Nga përllogaritja që është bërë në praktikë biznesi 2 deri në 8 milionë tatohej 7,5%, por kur është bërë përllogaritja i ka dalë më poshtë se 25 mijë lekë të rinj, ndërkohë që biznesi nga 0 deri në 2 milionë paguan një kuotë fikse 25 mijë lekë të rinj në vit. Ky ligj këtë rregullon dhe thotë: “Biznesi nga 2 deri në 8 milionë do tatohet 7,5%, por asnjëherë më poshtë se 25 mijë lekë që tatohet biznesi i vogël nga 0 deri në 2 milionë”. Që do të thotë se këtu vihet një dysheme për 25 mijë lekëshin.

Tani çdo lloj pyetje tjetër që bëhet, që e kemi këtë tatim 25 mijë për nga 0 deri në 2 milionë, do ta kemi për tatimin nga 2 deri në 8 milionë, nuk ka të bëjë me projektligjin që ka ardhur këtu, por me programin e qeverisë që është miratuar përpara një viti dhe që kemi kaluar dhjetorin e kaluar gjithë sistemin e taksave.

Faleminderit për vëmendjen!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino për sqarimin!

Zoti Fufi ka pyetje.

Mhill Fufi – Ka ndodhur një fenomen te Bashkia e Lezhës për taksën 25 mijë lekë të rinj. Bashkia e Lezhës e ka zgjidhur me 100 mijë lekë tatim, domethënë me 10 mijë lekë të rinj. A është shkelje kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Curri keni ndonjë koment? Kjo është çështje juaja, apo e autoritetit vendor?

Xhavit Curri – Unë di të them se çdo tatimpagues sado i vogël, në çfarëdo forme që ai të regjistrohet, nuk mund të paguajë tatim të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël më pak se 25 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Është shkelje apo nuk është shkelje, ju jeni deputet në atë qark dhe mund të kërkonit llogari.

Ka pyetje?

Vasilika Hysi – Zoti Curri, kam një pyetje, te shkalla tatimore ju përcaktoni dy paragrafë, te neni 11, thoni se nga 0 deri në 2 milionë lekë është 250, është fiks; ndërkohë që thoni se nga 2 deri në 8 milionë lekë, te paragrafi i parë, jo më pak se 250. Pra, përfshihet prapë edhe 250-ta. Pra, nuk bëhet ndonjë dallim nga 0 deri 8 milionë, sepse

250 thoni përsëri, kur thoni jo më pak, është jo më pak baras. Cili është dallimi? A mund të çojë në rritjen e ekonomisë informale, të çregjistrohen?

Xhavit Curri – Ajo që thotë pika 1 e këtij neni është që tatimpaguesit që janë të fashës 2-8 milionë në fakt paguajnë tatim të thjeshtuar mbi fitimin në masën 7,5% mbi fitimin që realizon dhe fitim është diferenca e të ardhurave me shpenzimet. Por ky tatim mund të jetë shumë më tepër se sa 25 mijë lekë, por në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 25 mijë lekë. Por mund të jetë edhe 25 mijë, sepse xhiro e tij mund të jetë 2 milionë.

Fatmir Xhafaj – Logjika është fare e thjeshtë: edhe nëse i del nën 25, 25 do të paguajë. Ky është tatimi dysHEME.

Kjo është përgjigja e tyre. Ju nëse jeni dakord, apo jo, mund të shpreheni.

Pandeli Majko – Këtu ka një problem, sepse ne nuk shikojmë kategorizim. Ju për të gjithë tatimpaguesit që kanë qarkullim 2-8 milionë lekë thoni jo më pak se 25 mijë dhe pastaj në paragrafin e dytë thoni që të gjithë tatimpaguesit nga 0 deri në 2 paguajnë përsëri 25 mijë. Nuk e di, jeni marrë ndonjëherë në jetën tuaj me biznes të vogël?

Fatmir Xhafaj – Nuk është i detyruar të merret me biznes të vogël.

Pandeli Majko – Ka një kategorizim këtu? Të dyja palët...

Fatmir Xhafaj – Se ju flisni pa mikrofoni dhe kështu t'i vini edhe gjrobat.

Pandeli Majko – Ju vini dhe thoni bordurën e kanë 25. Vendoseni në një paragraf. Të paktën nga ana legjislative vendoseni: nga zero deri kaq jo më pak se 25 dhe mbyllet historia. Por truke, për të thënë që po kategorizoni, kur nuk keni kategorizuar, nuk keni pse të sillni këtu. Vendosni një paragraf dhe thoni nga zero deri në kaq, jo më pak se 25. Se po të ishte për dy paragrafë, atëherë duhet që te paragrafi i dytë të mos ishte 25, por 20, të ishte dhjetë, të ishte pesë, sepse bëhet fjalë për njerëz, të cilët ju nënkuptoni, që e kanë qarkullimin zero. Edhe zero ta kem unë qarkullimin, prapë do të paguajë 25 mijë, njëlloj me këtë tjetrin?

(Ndërhyrje pa mikrofoni.)

Zotëri, unë nuk jam ekspert i tatimeve, por të lutem, mos më qesh, unë po të drejtohem me shumë seriozitet, se kemi dhe kamera. Më trego kategorizimin!

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Fino, si relator.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, që të kuptojmë një gjë. Ne kemi miratuar ligjin nr. 9632 më 30 tetor, ne bëjmë këtë ndryshim të këtij ligji. Ne vitin e kaluar kemi miratuar këtë kategorizim të tatimeve. Pra, kjo është risi që ka sjellë Partia Socialiste dhe e majta kur erdhi në pushtet. Deri në 2 milionë lekë xhiro nuk do të paguheshin, sipas atyre që ishin dje në pushtet, por paguajnë jo më shumë se 25 mijë lekë të reja, ndërsa nga 2 deri në 8 milionë, do të paguajnë 7.5 %. I vetmi ndryshim që sjellim ne në ndryshim të këtij ligji cili është? Në përlllogaritjen që bëhet për këtë fashë 2 deri në 8 milionë, 7.5-përqindëshi të mos bjerë më poshtë se 25 milionë, më poshtë se 25 mijë lekë të reja, dhe gjithë këto detyrime dhe shkalla tatimore janë të miratuara para një viti, ne nuk ndryshojmë shkallën tatimore këtu. Në qoftë se kërkojnë të ndryshojnë shkallën tatimore, t'ia kërkojnë qeverisë, ta sjellë, ta ndryshojë shkallën tatimore, që nga zero ta bëjmë jo në 2 milionë, por ta bëjë dhe një milion, nga një milion ta bëjë deri në 7 milionë, e kupton? Por ne këtë shkallë kemi vendosur zero deri në 2 milionë dhe 2 milionë deri 8 milionë. Këto janë fashat që kemi vendosur.

Fatmir Xhafaj – Ok. Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Curri, më fal, kenë përgjigjen pa dhënë për pyetjen e bërë nga zoti Majko, për shkallët.

Bashkim Fino – Jo, ajo që do të thosha në këtë rast është kjo: kategorizimi është shumë i qartë, ka dy fasho tatimpaguesish: një që shkon nga zero deri në 2 milionë dhe një tjetër që shkon nga 2 deri në 8 milionë. Mbi 8 milionë sigurisht që i nënshtrohen një regjimi tjetër tatimor. 2 deri në 8 milionë paguan 7.5 % tatim mbi fitimin, çka do të thotë që shumën e pagesës së tyre sigurisht që është më e madhe se 25 mijë lekë në vit, por mund të ndodhë në raste të rralla, për shkaqe manipulative, për shkaqe nga më të ndryshmet, që një tatimpagues në fakt pretendon të paguajë edhe nën 25 mijë lekë, edhe nën fashën e 0- 2 milionë. Pikërisht për t'ua prerë rrugën këtyre tentativave manipuluese ne kemi thënë që jo, ti nuk mund të zbresësh më poshtë se 25 mijë lekë në vit! Pra, nuk mund të zbresësh më poshtë se ata që realizojnë një xhiro 0-2 milionë. Kaq është e gjitha.

Fatmir Xhafaj – Ok, mbarojmë me pyetjet.

Ka diskutime?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Një vit më parë u kemi thënë qytetarëve se premtimi për taksat progresive dhe premtimi se do të përfitonin shumë më tepër nga ky sistem taksash progresive ishte një mashtrim. Sot e kemi të shkruar të zezën mbi të bardhë se premtimi përse taksa progresive do të ishte në favor të 98 % të shqiptarëve, është një mashtrim, sepse del sot e provuar qartësisht me këtë projektligj se qytetarët, bizneset paguanin shumë më pak se 250 mijë lekë në vit dhe sot po ua rrisim këtë 250 mijë lekësh. Është e qartë për të gjithë shqiptarët se 98 % e bizneseve janë ata që kanë xhiro 0 deri në 8 milionë lekë dhe 2 % janë ata bizneset e mëdhenj. Çfarë u thamë qytetarëve shqiptarë? Çfarë u thatë ju? Çfarë u premtuat? Si ua morët votat? U thatë se të gjithë barrën fiskale do ta mbajnë ata 2-përqindëshit, ndërsa këta që bëjnë xhiro nga 0 deri në 8 milionë lekë, këta nuk duhet të paguajnë fare taksa. A e mbani mend ju të gjithë se si ish – kandidati për Kryeministër shkoi atje, i kanë mediat kronikat, shkoi te Zogu i Zi dhe mori një copë letër dhe i bënte llogari asaj zonjës që shiste domate atje, dhe i tha: “Sot ti paguan 300 mijë lekë, nesër, tha, nuk ke për të paguar fare lek, tha. Si thua ti, tha, për kë do të votosh, për mua, apo për Saliun? Për ty, i tha ajo do të votoj”. Tani dilni dhe thuajini asaj qytetares të shkojë prapë me laps dhe me letër te Kryeministri dhe t’i shpjegojë se ajo zonja që shet atje dhe mijëra dhe mijëra biznese që janë nga Lezha, nga Shkodra, nga Gjirokastra, që nuk arrijnë dot të bëjnë 2 milionë lekë xhiro, ata nuk do të paguajnë më 50 mijë lekë apo 100 mijë lekë në vit, por do të paguajnë jo më pak se 250 mijë lekë. Dilni dhe thuajuni tani qytetarëve shqiptarë se me sistemin e taksave, me paketën e taksave, të cilën ne e kundërshtuam kur u miratua në fillim të këtij viti, u thatë qytetarëve shqiptarë se do të paguajnë më pak, i keni gënjyer, do të paguajnë shumë më tepër se sa paguanin një vit më parë, dhe ky është qëllimi.

U tha këtu, e tha edhe relatori, e thanë edhe këta që shpjeguan, u tha qartë se rezultonte se bizneset që bënin xhiro nga 0 deri në 2 milionë lekë, paguanin të paktën 250 mijë lekë, ndaj t’i futim të gjithë atje brenda, t’ua rrjepim lëkurën, t’u marrim edhe këtyre lekë sa më shumë. Se kështu ndodh, nga njëra anë sot në Komisionin e Ligjeve dy pikat e para të rendit të ditës është si të rrisim borxhin, të marrim hua sa të mundim. Por nga do t’i nxjerrim këto lekët e huas? Ja, t’i nxjerrim nga këta, nga këta 98 %, këtyre t’ua rrjepim lëkurën, këtyre që bëjnë një xhiro nga 0 deri në 2 milionë lekë, që bëjnë një xhiro nga 0 deri në 8 milionë lekë, me të tjerët nuk kemi punë, këta do ta paguajnë barrën, këta

i kanë zgjedhur. Ndaj dhe opozita është kundër. E kemi kundërshtuar këtë edhe më përpara, e kemi kundërshtuar që kur e artikuluat në fushatë zgjedhore. Taksa progresive është në dëm të qytetarëve shqiptarë, sistemi i taksave, paketa e taksave që po sillni është në dëm të qytetarëve shqiptarë, është në dëm të 98 % të qytetarëve shqiptarë, nuk është në të mirë të 98 % të qytetarëve shqiptarë. Do ta përkeqësojë jetën e 98 % të qytetarëve shqiptarë dhe nuk do ta përmirësojë jetën e tyre.

Dhe ja ku jemi sot. Kemi qenë kundër kur e artikuluat, kemi qenë kundër edhe kur e paraqitët paketën fiskale, jemi kundër edhe sot, sepse kjo paketë vjen në dëm të qytetarëve shqiptarë. Janë katër projektligje, një kemi ne, janë dhe tre të tjerë që do të kalojnë në komisionet e tjera për taksat vendore dhe për procedurat tatimore. Edhe kur e ngritëm në fillim, edhe në pikën e parë të rendit të ditës, do të regjistrohen, thanë, të gjithë fermerët, do të regjistrohen të gjithë se i duam ne, se do të përfitojnë ata nga shteti. Nuk do të përfitojnë nga shteti, sepse dhe çregjistrimi, te ai projektligji më parë, që ne votuam kundër, ishte në qoftë se ke paguar tatimet. Shteti nuk të thërret për të të dhënë, shteti të thërret për të të marrë, shteti të thërret për të marrë taksat.

Dhe ja ku vijmë këtu përsëri, shkallë pas shkalle, veprim pas veprimi, qëllimi i vetëm është që t'i rrjepim lëkurën qytetarëve shqiptarë, këtyre të varfërve, këtyre që kanë nga 0 deri në 8 milionë lekë, dhe çfarë do të ndodhë? Do të ndodhë ajo që u tha këtu edhe nga kolegët e maxhorancës, do të ndodhë ajo që njerëzit do të çregjistrohen. Por çfarë fitimi ka shteti? Do të ndodhë ajo që ka ndodhur edhe në vendet e tjera: bizneset ngrenë lekat dhe ikin, mbyllin edhe vendet e punës. Në vend që të hapin vende pune, në vend që të stimulojnë këta që punojnë vetë, nuk kanë njerëz të punësuar, vetëm nxjerrin bukën e gojës nga 0 deri në 2 milionë lekë, mezi bëjnë xhiro 2 milionë lekë në vit, në vend që ne t'i stimulojmë, në vend që të hapim vende pune, ne çfarë bëjmë? Ua marrim frymën këtyre, u themi jo më pak se 250 mijë lekë, deri dje paguanin 100 mijë lekë, paguanin 50 mijë lekë deri dje, dhe ata e dinë. Ne flasim këtu dhe ndoshta edhe na bën përshtypje dhe mund të mos na bëjë përshtypje, por ata që dëgjojnë, e dinë shumë mirë. Ata që paguanin deri dje 100 mijë lekë, do të paguajnë 250 mijë lekë, ata që paguanin taksë me sistemin e taksave më pak, sot do të paguajnë më shumë. Ky është sistemi, me këtë projektligj dhe me tre projektligjet e tjera që kanë sjellë, ndaj dhe ne jemi kundër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, në fakt mua më vjen për të qeshur dhe është për të qeshur në fakt që me këtë projektligj të bësh politikë. Me këtë projektligj nuk bëhet politikë. Më vjen keq për kolegun tim, por unë do të desha të dija si do ta priste lidhshipi i tij, Lul Basha, këtë diskutim të tij? Jam i bindur se do ta priste keq. E di pse do ta presë keq? Se këta nuk kanë kuptuar se ky projektligj ka të bëjë me taksën lokale, ky projektligj shkon totalisht te pushteti vendor, ky projektligj dhe kjo taksë është totalisht e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Çfarë po bëjmë ne? Po bëjmë një përlllogaritje që të mos ketë gabim, të vëmë një nivel dhe një standard për të gjithë. Domethënë, ai që bën një xhiro, pra një biznesmen i vogël, pra një tregtar i vogël, e kam për publikun, nuk e kam për këta, që bëni xhiro nga 0 -20 milionë lekë të vjetra në vit, paguan tatime 25 mijë lekë të reja, domethënë 250 mijë lekë të vjetra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

20 milionë lekë të vjetra është xhiro që bën një biznesmen, po flas me gjuhën e popullit, i bie që ky qytetar që bën 20 milionë lekë të vjetra xhiro, do të paguajë 250 mijë lekë të vjetra tatim në shtet dhe në bashki. Po 250 mijë lekë të vjetra, o shokë, t'ju them sinqerisht, është paga më minimale e një punonjësi dhe e një njeriu në muaj. Pra, çfarë dua të them me këtë? Dua të them se paguajnë në shtet 250 mijë lekë të vjetra, aq sa është paga minimale e një njeriu, domethënë shumë e ulët, që do të thotë se këtu kemi të bëjmë jo me politikë, por këtu kemi të bëjmë me një vendosje të ekuilibrit që ne i bëjmë me këtë projektligj duke thënë se këta që bëjnë 20 milionë lekë të vjetra xhiro, kaq, dhe paguajnë shumë, dhe nuk do të paguajnë më për gjithë vitin, ndërsa këta që bëjnë nga 20 milionë lekë të vjetra deri në 80 milionë lekë të vjetra xhiro në vit, do të paguanin 7.5 % të fitimit. Mirëpo nga përlllogaritja mund të dilte që ai mund të paguante edhe 1 milion e 900 mijë. Atëherë, ne me këtë projektligj themi jo, këtë rregullojmë, themi: nuk duhet të zbresim më poshtë se 250 mijë lekë të vjetra edhe në qoftë se ka manipulatore që kërkon të bëjë veprime që të mos paguajë taksën në bashkinë e Tiranës, në bashkinë e Shkodrës, në bashkinë e Gjirokastrës, e kështu me radhë, por 25 mijë lekë të reja ta paguajë ky që ka nga 2 deri në 80 milionë lekë të vjetra.

Pra, ky projektligj, zoti kryetar, nuk sjell asgjë, bën një përlllogaritje, është një veprim aritmetik, nuk ka të bëjë fare me politikën, nuk ka të bëjë fare me taksë progresive, nuk ka të bëjë fare me gënjeshtat e shqiptarëve të 98 %, përkundrazi, këtu përfitojnë vërtet 98 % e shqiptarëve. Në qoftë se doni të bëjmë politikë, jam gati, meqenëse e njoh sistemin e taksave, meqenëse njoh edhe organet e pushtetit vendor, të të them opozitës së sotme që deri dje bizneset e vogla paguanin edhe nga 600 mijë, edhe nga 800 mijë, të vjetra po flas gjithmonë, nuk po flas të reja, taksim në vit, ndërsa ne thamë: jo, do të paguajmë 250 mijë lekë të vjetra në tërë vitin, dhe i kemi ardhur në ndihmë biznesit të vogël me atë sistem taksor që vendosëm, dhe janë shumë të kënaqur me sitën që ne u kemi krijuar. Ndërsa sot me këtë projektligj ne duam që t'i bëjmë të ndershëm ata që punojnë, ata që bëjnë nga 2 deri 8 milionë, t'i bëjmë të ndershëm që të paguajnë 7,5 % të tatimit, por në qoftë se ajo vjen më poshtë se 25 mijë lekë, ne i themi tërhiq, jo, në asnjë mënyrë, ti do të paguash 7,5-përqindëshin, por në qoftë se na përlllogaritet të biem më poshtë se 25 milionëshi, pra 25 mijë lekë të reja, ti do të paguash prapë 25 mijë lekë të reja. Ky është ndryshimi që ka sjellë në këtë projektligj qeveria. Pra, është një veprim aritmetik dhe nuk ka të bëjë fare me politikë.

E fundit që kam është pikërisht kjo gjë: e gjithë kjo që diskutojmë çfarë bën? Shkon në funksion të organeve të pushtetit vendor. Është taksë qind për qind e pushtetit vendor. Kjo që ne po diskutojmë sot, kjo që ne themi se ata manipulorë që bëjnë 2-8 milionë lekë xhiro duan të paguajnë më pak se 25 mijë lekë, pra të paguajnë më pak në bashki, ne i themi: jo, stop i themi sot, ti do të pagush minimumi 25 mijë lekë dhe këtë do t'ia kalosh bashkisë si taksë vendore që ajo ta bëjë shërbime, gjithë shpenzimet e nevojshme që mund të bëjë një bashki me taksat vendore të saj.

Prandaj unë do të thosha, në këtë projektligj të paktën opozita duhet të ishte 100 % dhe të votonte, ndaj e thashë në fillim që nuk e di se si do ta presë kryetari i Bashkisë, dhe njëherazi kryetar i PD-së shqetësimin e kolegëve të vet deputetë të PD-së kur thonë se janë kundër kësaj, se në fakt janë kundër taksës vendore të vetë zotit Luli.

Faleminderit shumë!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Eduard Halimi – Dua të bëj një sqarim. Sigurisht, ne këtu jemi deputetë. Deputetët janë përfaqësues të popullit. Ata që na dëgjojnë, disa qeshin dhe disa qajnë.

Thonë, se këta i marrin nga një milion e gjysmë lekë në muaj, i fusin në xhep dhe sigurisht 250 mijë lekë nuk i duken asgjë, çfarë janë për këta 250 mijë lekë? Mund të qeshin disa dhe mund të qajnë, por kam përshtypjen se qajnë shumë. Dhe ajo që ne themi këtu dhe që veprojmë këtu si politikanë, politikë do të bëjmë, deputet, përfaqësues të popullit dhe do të flasim për qytetarët. Ajo që po u themi ne sot qytetarëve është që po bëre xhiro nga zero deri në 2 milionë lekë, ose e thënë ndryshe, po bëre 500 mijë lekë xhiro gjatë gjithë vitit, i bën apo nuk i bën, shteti 250 mijë lekë do t'i marrë ty kokërr më kokërr.

Për ne këtu mund të mos jenë asgjë, por për ata aty janë shumë, se i keni dëgjuar, dalin e flasin për qytetarët, ne nuk interesohemi se kujt do t'i ngrohet xhepi dhe kujt do t'i ftohet xhepi, por interesohemi për qytetarët. Dhe ky ligj vjen në kundërshtim me qytetarët, ndaj dhe e mora fjalën për të sqaruar që flas për qytetarët. Qytetarët me këtë paketë janë më keq se në vitin 2012, janë më keq se në vitin 2013. Kjo është.

Fatmir Xhafaj – Zoti Peza.

Dashamir Peza – Problemi është se po bëjmë politikë për politikë, nuk po bëjmë politikë ekonomike.

Fatmir Xhafaj – Po bëni politikë për një gjë që nuk bëhet fare politikë se është aritmetikë.

Dashamir Peza – Në këtë propozim që na ka ardhur nuk ka asnjë lloj ndryshimi. Çdo njeri që ka bërë biznes e di se kush bën biznes do të paguajë taksa. Ky është parimi i përgjithshëm. Sot me këtë ndërhyrje që po bëjmë thjesht po përcaktojmë një dysheme minimale për të gjithë, në mënyrë që të vendosim parimin e konkurrencës së barabartë në biznes. Ajo lloj politike, ku për qëllime të caktuara disa paguajnë dhe disa nuk paguajnë fare dhe lihet në vullnetin e lirë të atyre që administrojnë taksat, duhet të marrë fund, dhe kjo është në ndihmë të biznesit të vogël për t'i vendosur ata në kushtet e konkurrencës së barabartë dhe shmangies së bërjes së politikave me taksat.

Unë nuk arrij dot ta kuptoj. Ne kemi bërë një debat lidhur me këtë çështje dhe është e qartë dhe e provojnë shqiptarët në bizneset e tyre, a paguajnë më pak sot bizneset e vogla, apo paguanin më pak dje? Ajo që të gjithë shqiptarët e dinë, është se 95 % e shqiptarëve taksat janë ulur. Ajo që ne sot po bëjmë është të mos ketë grupe në biznesin e vogël, të cilët shmangin çdo detyrim tatimor dhe krijojnë një pabarazi në konkurrencë

në këtë fashë biznesi. Unë mendoj se është e shëndetshme kjo që bëjmë, unë mendoj se është pozitive kjo që bëjmë dhe është një përpjekje për ta futur në rrugën e normalitetit gjithë zhvillimin e këtij biznesi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza!

Zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam shumë dakord me parafolësin, është shumë e vërtetë që cilido që bën biznes duhet të paguajë taksë, edhe kjo është e padiskutueshme. Problemi që kam me ligjin që po diskutojmë sot, i cili nuk është aspak aritmetik, por është politik, është se ky tekst, domethënë kjo aksiomë se kush bën biznes duhet të paguajë taksa, nuk ka qenë teksti juaj deri më datën 23 qershor, por ka qenë teksti ynë. Ne kemi thënë: taksa, taksa njerëzore, taksa të ulëta, taksa normale, aq sa është e mundur minimale dhe t'i paguajnë të gjithë. Kryeministri aktual, kryetari juaj, ka pasur tekst tjetër. Deri më 23 qershor ai thoshte: “Askush nuk duhet të paguajë taksa”, ndaj vuri dhe përqindjen, 97 % do ta kenë taksën zero jo më të ulët siç sapo u tha këtu. Kryeministri deri më datën 23 qershor nuk u premtoi shqiptarëve ulje të nivelit të taksës, por u tha do të paguani zero.

Siç ju tha zoti Halimi, për një pjesë këtu mund të jetë pak 250 mijë lekë, atë që punon për bukën e gojës, që duhet edhe të ushqejë fëmijët, edhe të paguajë dritat, edhe të blejë ilaçet që Beqaj nuk i ka vënë nëpër spitale, por dhe të paguajë pak te polici dhe tek tatimori, është shumë, është një shumë e paarritshme. Megjithatë, këtë le ta vlerësojnë qytetarët nëse janë të lumtur me 250 mijë lekëshin minimalisht që ju vendosni, nëse i ngarkon 250 mijë lekëshi që ju minimalisht sot artimetikisht, jo politikisht, po i vendosni, atëherë le ta vendosin qytetarët, por një të vërtetë nuk i rrëshqisni dot: deri më 23 qershor ju u keni thënë njerëzve: bëni biznes sa të mundni, 97 % e juaja do ta kenë taksën 5 zero, jo një taksë normale minimale apo të ulët. Sot, me këtë përllogaritje aritmetike që po bëni, jeni minimalisht 250 mijë lekë më shumë se premtimi zero që iu dhatë, mund të jetë shumë, mund të jetë pak, mund të jetë e papërbalueshme, mund të jetë e përbalueshme, kjo është punë tjetër. Sot, haptazi, pafytyrësisht po gënjeni dhe po hani krejt fjalët që keni thënë në fushatë elektorale, arsye për të cilën morët votat. Kjo është e vërteta.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Është e thjeshtë, kanë sjellë një projekt, i cili thotë: “Nëse sot unë bëj një qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë, paguaj 25 mijë lekë të reja, ndërsa, nëse bëj një qarkullim nga 2 deri në 8 paguaj 7.5 %, por mund të më bjerë edhe 2 milionë lekë”. Logjika është që ky bën një xhiro më të vogël paguan më shumë se ky, ka një pabarazi të papranueshme. Projekti thotë: derisa ky zero deri në 2, paguan 25 mijë lekë të reja, ti që bën qarkullim mbi 2 milionë lekë, patjetër do të paguash të paktën 25 milionë lekë. Kjo është logjika, është fare e thjeshtë. Ju doni ta koklavisni. Koklaviteni se doni të bëni politikë mbi atë që nuk bëhet politikë, se atje ku ishte për të bërë politikë nuk ishin se nuk arritët dot në orar, tashti erdhët në orar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord? Vetëm një merak kam unë: 8 vjet ju për qytetarët a u hëngri ndopak meraku që merrnit 1.8, po tani kujtoni rrogat, 8 vjet kishit në pushtet, i morët me të dy duart, tani thoni se ne mendojmë për qytetarët. Po mendoni për qytetarët pasi keni mbushur xhepat, ë? Kjo është të mendosh për qytetarët. 8 vjet ishit në pushtet, 8 vjet mbushët xhepat dhe tani thoni: “Mendojmë për qytetarët”. Kjo është logjikë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë po bëjmë, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ki durim, ki durim! Hajde në orar që ta kapësh temën e ditës, je me vonesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? 4 kundër.

Miratohet në parim.

Vazhdojmë nen për nen.

Neni 1.

Zoti Fino?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Te neni 1, jeni dakord?

Zoti Majko.

Pandeli Majko – E kam me tatimet, sikur ta propozojmë ne, domethënë, se duket sikur, do të më falni, do e vendosni ju, ne propozim bëjmë, sikur për këta që kanë zero deri në 2 milionë, të bëhet 5 mijë lekë, pra të ketë një farë shkallëzimi, zero deri në 2 milionë, të jetë fiks deri në 5 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për zero deri në 2 milionë, pra zero, që nuk ka asnjë fitim, zero deri në 2 të jetë 5 mijë lekë.

Fatmir Xhafaj – Nuk është pjesë e këtij ligji, është një propozim për...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni koment?

Pandeli Majko – Na jepni një konsideratë, se ne e kemi një ide.

Geraldina Prodani – Nuk adresohet në këtë ligj, ajo duhet të jetë pjesë e paketës fiskale se bëhen llogaritjet e efekteve financiare dhe të gjitha, ka një debat dhe një diskutim më të gjerë. Kështu që duhet të adresohet atje, por nuk adresohet në këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, te paketa fiskale.

Fatmir Xhafaj – Ok. Gjithsesi, mbajeni në konsideratë, bisedojeni me Komisionin e Ekonomisë, ne po ia çojmë Komisionit të Ekonomisë që t’ia adresojë ministrisë ta ketë në konsideratë te përshkallëzimi në momentin që do të vijë ligji fiskal.

Faleminderit!

Geraldina Prodani – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Më fal zoti Majko!

Pandeli Majko – Është shumë e rëndësishme. Në vazhdim të asaj që tha kryetari, ne do t’ia çojmë Komisionit të Ekonomisë. Mendoj se ky është përshkallëzim, është i kuptueshëm, është i mirëkuptueshëm të bëhet 5 mijë lekë të reja në vit për këta që kanë zero deri në 2 milionë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 2.

Ka sugjerime apo vërejtje?

Nuk ka. Dakord?

Dakord me nenin 2.

Neni 3.

Ka vërejtje, sugjerime apo propozime? Dakord.

Miratohet.

Neni 4.

Ka vërejtje, sugjerime? Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? 1 votë kundër.

Kalon edhe ky projekt.

Zoti Halimi i qëndroi stoik asaj që tha, qëndroi deri në fund, kolegët e vet u larguan për të qarë hallet me qytetarët jashtë komisionit, kështu që zoti Halimi qëndroi deri në fund, është korrekt me atë çfarë tha, kështu që jam i detyruar të respektojme votën e tij kundër.

Këtu e mbyllim këtë projekt, këtu e mbyllim edhe rendin e ditës, sepse lidhur me pikën e fundit të rendit të ditës, për KQZ-në, që presin mediat, nuk është relatori, nuk është dhe zoti Bylykbashi përsëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Unë nuk mund të rri tri ditë këtu.

Fatmir Xhafaj – Edhe relatori ynë nuk është këtu, të jemi të ndershëm.

Bashkim Fino – Kemi tri ditë që e shtyjme, pastaj këta le ta shikojnë në seancë plenare, nuk e shtyjme ne...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Bashkim Fino – Si dakord?

Fatmir Xhafaj - E lamë për pasdite, se edhe zoti Klosi do të vijë pasdite.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne e kalojmë edhe pa zotin Klosi, por zoti Bylykbashi përsëri më kërkoi mirëkuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në orën 17:00 zhvillohet mbledhja e Komisionit të Ligjeve, shqyrtohet projektligji “Për Policinë e Shtetit” në parim. Do të jetë ministri i Brendshëm.

Faleminderit!

\



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.07.2014, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për Policinë e Shtetit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Oerd Bylykbashi Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Arben Ristani, Silva Caka, Keltis Kruja dhe Gent Strazimiri.

Mungojnë:

Dashmir Peza, Mark Frroku, Ulsi Manja, Tom Doshi, Eduard Halimi, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Fatmir Mediu dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Saimir Tahiri – ministër i Brendshëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Meqenëse formohet kuorumi, mund ta fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për Policinë e Shtetit”. Ky projektligj ka kohë që është në dispozicion të të gjithë kolegëve deputetë, të cilët janë njohur gjerësisht me përmbajtjen e tij. Gjithsesi, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, kohën e nevojshme në dispozicion, si dhe për t’u dhënë mundësi deputetëve për t’u përgatitur për debatin nen për nen, sot do të bëjmë paraqitjen dhe shqyrtimin në parim. Gjatë ditëve në vijim do të fillojmë diskutimin nen për nen.

Në këtë mbledhje të komisionit është i pranishëm zoti Saimir Tahiri, ministër i Brendshëm së bashku me ekipin e ministrisë.

Zoti Ministër, faleminderit që jeni i pranishëm, si zakonisht, kur shqyrtohen dhe debatohen projektligjet që lidhen me ministrinë tuaj!

Fillimisht do të donim një ekspozë të shkurtër nga ana juaj, pastaj do të fillojmë me procedurën e zakonshme të pyetje-përgjigjeve.

Fjala është për ju.

Saimir Tahiri – Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të reformës ligjore në sektorin e sigurisë dhe në kuadër të të gjitha projektligjeve të prezantuara për shqyrtim në Kuvend nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga qeveria, e them pa asnjë mëdyshje se ky është ligji më kryesor, që përbën “shtyllën kurrizore” të reformës në Policinë e Shtetit, por edhe në të gjithë sektorin e sigurisë për nga dimensionin e reformës dhe për nga standardet që sjell në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ligji është ndërtuar duke pasur parasysh angazhimet e qeverisë, duke pasur parasysh dokumentet kryesore dhe themelore në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në standardet e policimit në vendet e Bashkimit Europian.

Ligji është hartuar nga ekspertët më të mirë të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, në bashkëpunim me ekspertë të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe në bashkëpunim me ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë.

Njëkohësisht, në fazat paraprake të hartimit, ligji është draftuar së bashku me asistencën e misionëve partnere, që asistojnë Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, të tilla si OSBE-ja, PAMECA dhe ICITAP-i. Jam krenar t'ju bëj me dije se kemi arritur të gjejmë gjuhën e përbashkët për të prezantuar në parlament një projektligj, i cili në thuajse të gjitha dispozitat e veta bashkëndon konsensusin e të gjithë partnerëve, të cilët i përmenda më sipër.

Projektligji për “Policinë e Shtetit” është ndërtuar i tillë për të garantuar polici demokratike në funksionim dhe në organizim; për të garantuar respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe për të garantuar detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me shoqërinë civile dhe agjencitë e agjentët shoqërore që kanë ndikim të caktuar në komunitet.

Policia është agjencia kryesore ligjzbatuese, si e tillë, përkundër praktikave të deritanishme, në ligjin e ri për Policinë e Shtetit është konceptuar si një organizatë transparente dhe, mbi të gjitha, llogaridhënëse, dhe jo si një institucion i mbyllur, pa garantuar aksesin e qytetarëve e kontrollin e qytetarëve në veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Ligji është ndërtuar duke pasur parasysh që siguria dhe garantimi i sigurisë për qytetarët dhe sipërmarrësit nuk është dhe nuk mund të jetë sipërmarrje ekskluzive e Policisë së Shtetit, por është sipërmarrje e përbashkët e shoqërisë, e individit, e të gjithë institucioneve dhe, natyrisht, e Policisë së Shtetit.

Në ligj sanksionohet si parim meritokracia, karriera e bazuar mbi rezultate dhe matja periodike e rezultateve të punës dhe e përformancës. Të gjitha këto janë konceptuar si parime ekskluzive mbi të cilat duhet të ngrihet karriera e çdo punonjësi dhe oficeri të Policisë së Shtetit.

Në ligj sanksionohet parimi “Një shtet - një polici”, duke hedhur themelet për të mos lejuar shpërndarjen, kaosin apo anarkinë e attributeve të Policisë Gjyqësore në shumë agjenci ligjzbatuese. Kjo do të thotë se kemi parashikuar në ligj që krime, të cilat deri dje fshiheshin pas vakuumit ligjor apo mosveprimit të strukturave ligjzbatuese apo

lojës, shpeshherë, “e ka kush e ka”, por në përfundim se ka askush, të mos gjejnë më boshllëqe, duke sjellë si pasojë mosndëshkimin e autorëve që konsumojnë vepra të tilla penale, të tilla si ndërtimet pa leje apo krimet mjedisore, të cilat deri dje nuk kanë hyrë në veprimtarinë e përditshme të Policisë së Shtetit, pavarësisht se ishin të parashikuara në Kodin Penal.

Ligji i ri hedh bazat (e natyrisht që kjo do të kërkojë amendime në ligje sektoriale) për të garantuar mishërimin e parimit “Një shtet - një polici”, duke garantuar parandalimin dhe ndëshkimin e çdo lloji veprave penale, mbi të gjitha, të atyre të cilat deri dje ishin vepra penale që, edhe pse nuk e preknin individin drejtpërdrejt, e cenonin shoqërinë shumë.

Ligji i ri hedh bazat për të forcuar veprimin policor, me qëllim parandalimin dhe ndëshkimin e të gjitha veprave penale. Gjithashtu, ligji i ri garanton distancë klinike, e cila duhet të ekzistojë mes Policisë së Shtetit dhe autoritetit politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për të garantuar depolitizimin e Policisë së Shtetit nga njëra anë dhe depolicizimin e vendimmarrjes politike nga ana tjetër. Kjo do të thotë se ministri dhe ekipi politik ka kompetenca strategjike, planifikuese dhe monitoruese duke u ndarë qartë nga çdo lloj kompetence që duhet të jetë kompetencë ekskluzivisht policore, të tilla siç janë kompetencat operacionale.

Ligji i ri hedh një hap në demokratizimin e Policisë së Shtetit, në depolitizimin e saj, duke përcaktuar kritere të vetorganizimit, të vetëkontrollit, të menaxhimit operacional, si dhe të çështjeve të tjera, që duhet të mbeten ekskluzive të Policisë së Shtetit.

Ligji përcakton kritere dhe parime për të organizuar policinë në bazë të popullsisë, duke garantuar që shërbimi policor të jetë sa më afër qytetarit, duke ndërtuar një piramidë të qëndrueshme, e cila e shtrin dhe e afron Policinë e Shtetit dhe shërbimin e sigurisë më afër qytetarit.

Në vetëdijen tonë, siguria, në radhë të parë, është aty ku gjendet dhe rreziku dhe kjo është aty ku janë qytetarët.

Ligji përcakton kritere të forta karriere, merite dhe sistem gradash që i përgjigjen domosdoshmërisë për përmbushjen e detyrës nga punonjësit e Policisë së Shtetit, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë në detyrë, por, mbi të gjitha, për të garantuar

patundshmërinë për motive të tjera, përveç atyre të parashikuara në ligj, dhe që kanë të bëjnë me performancën dhe me përmbushjen e detyrës.

Ligji përcakton një sistem gradash që eviton korrupsionin, eviton tarafin apo qokat politike për ata që në polici duhet të ngrihen në detyrë ose të bëjnë karrierë bazuar vetëm mbi ligjin, mbi meritën, në bazë të rezultateve dhe përkushtimit në detyrë. Kjo sanksionohet duke përcaktuar në ligj si instrument për ngritjen në gradë dhe për karrierën procesin e konkurrimit transparent.

Ligji, gjithashtu, nuk shkon me idenë e deritanishme që punonjësit e policisë janë në detyrë pavarësisht përmbushjes së detyrës, por përcakton teste vjetore ose periodike për punonjësit e policisë dhe matje vjetore të performancës. Kjo do të thotë se një punonjës, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet domosdoshmërisht t'i përgjigjet detyrës, të përmbushë detyrën ndaj publikut dhe t'u përmbahet standardeve ndaj detyrës, në mënyrë që të vazhdojë t'i shërbejë publikut në Policinë e Shtetit.

Me këtë ligj parashikohet ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila është konceptuar për t'i dhënë një standard të ri luftës kundër korrupsionit elitar dhe veprimtarive kriminale të lidhura me të, duke parashikuar edhe kriteret e veçanta për rekrutimin në Byrosë Kombëtare të Hetimit, për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe për veprimtarinë hetimore policore të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Në këtë Ligj është parashikuar domosdoshmëria që Policia e Shtetit të aksesojë në mënyrë të menjëhershme të gjitha databazat shtetërore dhe private të të dhënave.

Sot pengesa kryesore, ose një ndër pengesat më të mëdha në hetime, është mungesa e informacionit ose pengesa për të marrë informacion, të cilat ose janë absolute, ose janë relative, të tilla deri në pikën kur informacioni vjen shumë vonë, aq sa nuk i hyn më në punë hetimit.

Me këtë ligj kemi synuar të hedhim një hap përpara, dhe ky është një shqetësim edhe për partnerët, për të garantuar që oficeri i policisë, i cili zhvillon hetimet për një ngjarje kriminale, të aksesojë sa më shumë të dhëna shtetërore ose jo që nga tavolina e zyrës mundësisht, gjithsesi të mos ketë asnjë pengesë, as absolute dhe as relative, për të aksesuar databazat e të dhënave, të cilat janë të nevojshme në një hetim, kuptohet, duke respektuar të dhënat ligjore të legjislacionit penal në fuqi.

Ky ligj përcakton një standard modern për arsimimin policor. Deri më sot ju e dini, ka ekzistuar arsimimi policor bazë, por që ka krijuar një vakuum jo të vogël në kapacitetin tonë për të pasur oficerë të kualifikuar hetimor në Policinë e Shtetit. Kjo ka sjellë standard të ulët të punonjësve të Policisë së Shtetit, për t'iu përgjigjur sfidave të sotme në luftën kundër kriminalitetit, që sigurisht nuk është më kriminalitet mediokër apo vetëm ai i rrugës, por veçanërisht natyrës së re të krimeve, krimi kibernetik, krimi që ka të bëjë me çështje financiare, si pastrimi i parave, por edhe çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin elitar dhe me krimin e organizuar.

Me këtë ligj hapim rrugën për të krijuar specialistë të lartë të parandalimit dhe hetimit të krimit, të cilët do të shkollohen me kurrikula bashkëkohore. Gjithashtu, hapim rrugën që të rinjtë e shkolluar jashtë Shqipërisë, me formim policor në shkolla jashtë vendit, të mund të rekrutohen në Policinë e Shtetit Shqiptar në përputhje me nivelin arsimor dhe me gradën përkatëse që u takon.

Deri më sot ndodhte që një i ri që shkollohej jashtë Shqipërisë dhe i ndodhte të bënte edhe 4 vjet shkollë, të vinte në Shqipëri të merrte një gradë më të ulët se një oficer policie që mbaronte kursin 6 mujor në Shqipëri. Kjo ishte tërësisht e papajtueshme për aspiratën e kujt do të riu, i cili donte të përputhte vitet e shkollës dhe arsimimin me karrierën në polici.

Ky ligj bën edhe përputhjen e arsimimit të të rinjve me domosdoshmërinë për të bërë karrierë në Policinë e Shtetit.

Më konkretisht, projektligji për Policinë e Shtetit parashikon zgjerimin e detyrave të policisë, duke përfshirë parandalimin, hetimin dhe zbulimin në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural në fuqi të veprave penale dhe autorëve të dyshuar në fushën e ndërtimit, të kontrollit të mjedisit dhe territorit.

Sanksionon pavarësinë operationale të drejtorit të Policisë së Shtetit dhe të strukturave në varësi nga ministri dhe nga të gjitha autoritetet politike në Ministrinë e Punëve Brendshme, duke sanksionuar mosinformimin për veprime procedurale hetimore dhe informacione të tjera, të cilat kanë të bëjnë me hetimin për autoritetet politike që drejtojnë MPB.

Ndryshojnë kriteret për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Policisë së Shtetit, ku nuk do të ketë më vetëm një kandidat të propozuar, por do të zgjidhet ndërmjet

3 kandidatëve, duke përcaktuar kështu një standard demokratizimi në përzgjedhje të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, sanksionon një piramidë, duke filluar me zëvendës drejtorët, të cilët deri dje ishin 5, por në ligjin e ri parashikohet vetëm 1, që do të ketë atributet të përcaktuara mirë dhe mandat të përcaktuar mirë, sipas funksionit të detyrës, bazuar te ligji.

Drejtori i Policisë së Shtetit bazuar në këtë ligj, pas përfundimit të mandatit, nuk do të kthehet më në polici, por, gjithashtu, do të trajtohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, duke përbërë kështu edhe garanci për ushtrimin e detyrës së tij.

Përcaktohet ecuria në karrierë nëpërmjet një sistemi gradash, siç e thashë, duke e konceptuar gradën si një të drejtë të fituar nga punonjësi i policisë nëpërmjet procesit vlerësues dhe konkurrues.

Gjithashtu, është ulur edhe numri i gradave për ta bërë policinë eficiente në strukturë dhe në veprimtari.

Ligji i ri përcakton parimet sipas të cilit grada merret në bazë të meritës dhe jo në bazë të vendit të punës.

Projektligji ofron dhe garanci për punonjësit e policisë në ushtrimin e detyrës dhe përcakton detyrimin e punonjësit të policisë për vlerësimin periodik të performancës. Gjithashtu, punonjësit të policisë, për të respektuar sa më shumë parimin e depolitizimit, i ndalohet jo vetëm që të jetë një anëtar partie ose organizate politike, por i ndalohet edhe të mbështesë në mënyrë fizike apo financiare aktivitetin elektorale të çdo partie ose të çdo kandidati të përfshirë në zgjedhje.

Për të garantuar qëndrueshmërinë e punonjësve të policisë në detyrë, është përcaktuar që punonjësi i policisë nuk mund të transferohet pa kaluar minimumi dy vjet në detyrën që ka.

Ju bëj me dije se në vitin 2013, brenda 7 muajve të parë të vitit 2013, janë transferuar nga njëra detyrë në detyrën tjetër gati 90 për qind e Policisë së Shtetit. Kjo do të thotë se koha mesatare e qëndrimit në detyrë për punonjësit e policisë ishte më pak se dy muaj, kur në të gjitha vlerësimet e performancës dhe përmbushjes së detyrës, minimumi për t'u njohur me detyrën dhe për të marrë përsipër detyrën, varion nga 20 ditë

deri në 1 muaj. Kjo do të thotë se ishte fizikisht e pamundur për të përmbushur detyrën për shkak të lëvizjeve masive në Policinë e Shtetit.

Për t'i dalë përpara përsëritjes së situatave të tilla dhe për të ndaluar apo parandaluar që punonjësit e policisë të transferohen pa asnjë kriter nga një detyrë në një detyrë tjetër, kemi përcaktuar në ligjin e ri të policisë që asnjë punonjës policie nuk mund të transferohet nga një detyrë në një detyrë tjetër pa përmbushur minimumi dy vjet në detyrën që ka.

Rekrutimet në Policinë e Shtetit garantojnë sigurinë maksimale për të parandaluar përfshirjen e punonjësve të policisë në veprimtari kriminale, duke krijuar databasën e të punësuarve në Policinë e Shtetit, që fillon me marrjen e shenjave të gishtave, të të dhënave të ADN-së apo të çdolloj të dhëne tjetër, e cila ka të bëjë me identitetin dhe me veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit deri në momentin që rekrutohet në polici.

Përcaktohet që drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit të mos jetë ngushtësisht i emëruar vetëm nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, por përcaktohet gjithashtu edhe mundësia për t'u emëruar nga radhët e prokurorëve, duke përcaktuar garancinë që secili prej tyre, pas përfundimit të mandatit të parashikuar në ligj, të kthehet përsëri në detyrën që ka mbajtur ose në detyrë të ekuivalentuar me detyrën që ka mbajtur përpara emërimit si drejtues i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në këtë ligj përcaktohet mundësia që në Policinë e Shtetit të rekrutohen persona, të cilët kanë aftësi të veçanta në fusha të tjera, pavarësisht faktit se nuk kanë arsimin policor. Ajo që vihet re është mungesa e kapacitetit njerëzor dhe profesional në Policinë e Shtetit për të hetuar një sërë veprimtarish kriminale, arsimimi për të cilat nuk merret nga kurrikulat e arsimit policor. Prandaj është e domosdoshme që Policia e Shtetit të ketë mundësi të shfrytëzojë burimet njerëzore dhe profesionale në shoqëri, duke i rekrutuar në Policinë e Shtetit pas një eksperience të caktuar dhe nëpërmjet një procedure të caktuar, për të pasuruar dhe ngritur nivelin e hetimeve me kapacitete profesionale që Policia e Shtetit sot nuk i ka dhe për një periudhë kohe të caktuar nuk do t'i ketë. Si element garancie është parashikuar se numri i personave që nuk kanë formimin policor dhe që do të rekrutohen në Policinë e Shtetit për poste dhe për njohuri të veçanta profesionale nuk mund të jetë më shumë sesa 1% e numrit të përgjithshëm dhe limitit organik të Policisë së Shtetit.

Si detyrë funksionale e Policisë së Shtetit dhe si përgjegjësi përcaktohet ruajtja dhe sigurimi i personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve me rëndësi të veçantë, përgjegjësi që deri më sot e ka pasur Garda e Republikës, e cila, sipas këtij projektligji, shndërrohet në një strukturë në varësi të Policisë së Shtetit, por strukturë me natyrë specifike dhe të veçantë.

Përcaktohet detyrimi që duhet të kenë institucionet shtetërore apo private për t'i dhënë të dhëna Policisë së Shtetit në lidhje me hetimet që zhvillon Policia e Shtetit dhe prokuroria në bazë të legjislacionit penal në fuqi.

Në ligjin e ri përcaktohen dhe trajtohen për herë të parë si kategori e nëpunësit civil punonjësit me funksione ndihmëse, duke i kategorizuar ata dhe duke rregulluar marrëdhëniet e punës në bazë të Kodit të Punës dhe ligjit të nëpunësit civil, duke parashikuar kështu që funksionet, të cilat nuk është e domosdoshme që të kenë karakter policor, të mbeten në të ardhmen funksione me natyrë jopolicore, pra funksione civile.

Për herë të parë në këtë projektligj parashikohet mundësia që Policia e Shtetit të kërkojë dhe të vendosë në dispozicion të saj në raste emergjencash apo fatkeqësi natyrore edhe punonjësit e shërbimeve të sigurisë private ose policitë private, siç rëndom njihen, dhe detyrimin e tyre për të bashkëpunuar me forcat e policisë në rastet e parashikuara sipas ligjit. Gjithashtu në ligj parashikohet supremacia e Policisë së Shtetit përballë çdo agjencie tjetër në rastet e parashikuara në këtë ligj.

Në këtë ligj parashikohet që Policia e Shtetit, në zbatim të këtij ligji, të ketë vetëm një rregullore dhe jo disa, siç ka pasur deri më tani, duke sjellë kështu qëndrueshmëri, parashikueshmëri dhe jo kaos në akte të tilla nënligjore, që një ndër më të rëndësishmit është dhe rregullorja e Policisë së Shtetit. Këto janë pak a shumë tiparet dhe karakteret dalluese të ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”. Natyrisht, ky është një ligj mjaft i rëndësishëm dhe mbetemi të hapur për çdo sugjerim apo pyetje nga kolegët deputetë.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka relatorja, e cila në mënyrë të përmbledhur do të na bëjë një paraqitje të këtij projektligji, pa hyrë nën për nën, meqenëse ajo i takon një procedure tjetër.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezencën në Komisionin e Ligjeve dhe për paraqitjen e hollësishme të projektligjit “Për Policinë e Shtetit”, i cili, siç e thatë edhe në fjalën tuaj, është një projekt shumë i rëndësishëm, që meriton të gjithë vëmendjen e anëtarëve të këtij komisioni!

Unë shkurtimisht do të ndalem në të rejat që sjell ky projekt, si dhe në problematikat, që mendoj se kanë një rëndësi më të veçantë, për të cilat ne duhet të shohim edhe opinionin e aktorëve të fushës.

Ky projektligj ka si qëllim të përcaktojë misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe të drejtat e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon marrëdhëniet e punës, karrierën, mirëqenien dhe vazhdimësinë në detyrë të punonjësit të policisë. Projektligji synon të rrisë autoritetin e Policisë së Shtetit, jo vetëm si një institucion përgjegjës për rendin dhe sigurinë në vend, për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, por gjithashtu edhe si një institucion, i cili ka të drejtë të marrë masa administrative për çdo shkelje të ligjit në të gjithë territorin e vendit, natyrisht kur kjo nuk përbën vepër penale.

Me anë të këtij projektligji synohet të përmbushen prioritetet kyçe të Komisionit European për Shqipërinë për sa i takon forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe korrupsionit. Në këtë projektligj reflektohen edhe rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizata të shoqërisë civile, si dhe mendimet që kanë dhënë misionet ndërkombëtare që asistojnë në Policinë e Shtetit.

Unë do të ndalem te risitë e rëndësishme të këtij projektligji.

Në këtë projekt parashikohet krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, që është një strukturë e veçantë dhe do të jetë pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit, e cila kryen veprimtari gjurmuese dhe hetimore në përputhje me legjislacionin penal dhe atë procedural për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe të veprave penale të lidhura me të.

Së dyti, në përgjegjësinë e Policisë së Shtetit do të jetë ruajtja dhe siguri i personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve me rëndësi të veçantë, përgjegjësi që më parë i ka pasur Garda e Republikës, e cila, sipas këtij projektligji, bëhet strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit.

Së treti, në këtë projekt përcaktohet se struktura e kufirit dhe emigracionit do të jetë në përbërje të policisë me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Së katërti, përcaktohet më mirë ecuria në karrierë nëpërmjet një sistemi gradash, të konceptuar si një e drejtë e fituar nga punonjësit nëpërmjet procesit vlerësues dhe konkurrues.

Së pesti, përcaktohet se policia do të ketë institucionin e saj arsimor, përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit. Ky institucion do të ofrojë specializime dhe kualifikime për institucionet e zbatimit të ligjit për personat fizikë dhe juridikë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

Me këtë projektligj garantohet një nivel më i lartë, ky është një premtim që ne e kemi bërë edhe gjatë fushatës elektorale, i trajtimit financiar të punonjësve të policisë në raport me natyrën e veçantë të punës së tyre. Në përgjithësi, sipas këtij projekti, punonjësit e policisë do të gëzojnë një trajtim absolutisht më të mirë. Në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre ata do të përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë; do të gëzojnë të drejtën për t'u trajtuar me kredi të butë për strehim; të drejtën e kompensimit kur emërohen apo transferohen jashtë vendbanimit të tyre të përhershëm, brenda apo jashtë vendit; të drejtën e sigurimit të jetës; të drejtën e punonjësit të policisë për mbrojtje të veçantë kur u kërcënohet jeta, familja ose prona për shkak të detyrës. Gjithashtu përcaktohen edhe rastet kur punonjësit e policisë përfitojnë trajtim financiar, pasi janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe subjektive. Po ashtu garantohet edhe detyrimi që Policia e Shtetit do të ketë për të informuar dhe për të bashkëpunuar me shoqërinë civile, detyrim i Policisë së Shtetit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet shtetërore apo edhe private që prodhojnë baza të dhënash, gjithmonë kur këto konsiderohen dhe janë të nevojshme për t'i dhënë informacion Policisë së Shtetit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Unë dua t'u bëj me dije të gjithë anëtarëve të këtij komisioni që Komisioni i Ligjeve i ka kërkuar mendim paraprakisht edhe zyrës së prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me këtë projektligj. Sot na është vënë në dispozicion edhe materiali i sjellë nga prokurori i Përgjithshëm. Besoj se në ditët në vijim ne do të kemi mundësinë që së bashku të diskutojmë për disa çështje, konkretisht për sa i takon krijimit dhe funksionimit

të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kjo është një strukturë, e cila, sipas projektit, do të kryejë veprimtari gjurmuese dhe hetimore për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe të veprimtarisë kriminale lidhur me të.

Nëse do t'i referohemi ligjit “Për Policinë e Shtetit” në Slloveni, do të vëmë re se fusha e veprimtarisë të Byrosë Kombëtare të Hetimit është pak më e gjerë, sepse byroja parashikohet si një njësi e specializuar për hetimin jo vetëm të krimit të korrupsionit, por edhe për krime në fushën ekonomike dhe për krimin e organizuar. Natyrisht, të hetosh krime të tilla duhet të parashikosh që pjesë përbërëse e Byrosë të jenë individët më të kualifikuar për sa u përket hetimeve në këtë fushë dhe duhet të ketë një angazhim më të lartë nga ana e disa e institucioneve shtetërore, që janë përgjegjëse të fushës, si taksat, doganat etj.

Besoj se këtu duhet të ndalemi dhe të marrim në referencë të gjitha vërejtjet që janë bërë nga prokurori i Përgjithshëm në lidhje me këtë organ: si do të jetë përbërja e tij, si do të kujdesimi që ky organ të mos krijojë dualitet në veprimtarinë e tij me atë të organit të prokurorisë, veçanërisht të Prokurorisë për Krimet e Rënda, sepse Prokuroria e Krimeve të Rënda ka pak a shumë të njëjtin fokus hetimi që do të ketë edhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Kështu që ne duhet të kujdesimi që asnjëra të mos i mbivendoset tjetrës dhe të mos tejkalojmë parashikimet kushtetuese, sepse drejtimin dhe kontrollin e hetimeve e ka prokurori, pra të dyja bashkë.

Kriteret e emërimit dhe të qëndrimit në detyrë të drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Policisë së Shtetit duhet të përforcohen, sepse kriteri i vetëm i vendosur për të dyja këto pozicione është ai i gradës. Përkatësisht, drejtori i Policisë së Shtetit përzgjidhet ndërmjet punonjësve të policisë që mbajnë gradën “Drejtues i lartë” ose “Drejtues i parë”, ndërsa zëvendës drejtori i Policisë duhet të ketë gradën “Drejtues i parë”. Pra, sugjeroj që të shtohen kriteret në lidhje me personin që do të drejtojë Policinë e Shtetit, të cilat duhet t'i referohen eksperiencës, arsimit dhe kualifikimeve të ndryshme profesionale në kohë.

Në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë, ka një mospërputhje midis kohës që qëndron në detyrë drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe kohës që duhet të qëndrojë në detyrë zëvendës drejtori. Për drejtorin është parashikuar një mandat me një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, me të drejtë riemërimi për tre vjet, ndërkohë që zëvendës drejtori do të ketë një mandat prej katër vjetësh, me të drejtë riemërimi në një periudhë prej 2 vjetësh. Është

e paqartë pse drejtori i Policisë së Shtetit nuk rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit pasi të përfundojë mandatin ose kohën e qëndrimit në detyrë.

Problematikë tjetër për të cilën besoj se ia vlen të ndalemi ka të bëjë me rastet e shoqërimit të shtetasve nga punonjësit e policisë në mjediset e policisë. Vihet re se ka ndryshime në këtë pikë në raport me ligjin ekzistues, sepse është zgjeruar numri i rasteve ku policia do të ketë të drejtë të shoqërojë persona në ambientet e policisë. Unë nuk po i përmend rastet, sepse besoj se kolegët i kanë parë në projekt. Por duhet të bëhet kujdes, sepse disa nga këto raste rregullohen shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale. Në këtë rast ne duhet t'i përmbahemi Kodit të Procedurës Penale, sepse ai është prioritar në raport me këtë ligj. Ky është një ligj i thjeshtë, ndërsa Kodi është një ligj i cilësuar.

Në nenin 114 të projektligjit parashikohet kontrolli mjekësor i personit. Besoj se edhe këtu duhet të ndërhyjmë me një kujdes të veçantë, sepse duhet të kemi parasysh se çfarë parashikon Kodi i Procedurës në këtë pikë. Pra, si ushtrohet kontrolli mjekësor ndaj një personi dhe si duhet të garantohen të drejtat e këtij personi gjatë kohës që ne kërkojmë të bëjmë këtë kontroll.

Një sugjerim që vjen edhe nga misioni PAMECA, që besoj se e ka asistuar nga afër punën tuaj, është edhe ai që lidhet me faktin se në një ligj të cilësuar, siç është ligji për nëpunësin civil, në nenin 3 të tij është parashikuar konkretisht: "Punonjësit e policisë dhe punonjësit e shërbimit të jashtëm janë nëpunës civilë ndaj të cilëve zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm". Pra, duhet të diskutojmë, sepse projektligji nuk ua njeh statusin nëpunësit civil oficerëve të policisë dhe për rrjedhojë ka një lloj konflikti me ligjin për nëpunësin civil. Pra, duhet të diskutojmë për statusin që do të kenë.

Një problematikë tjetër na vjen edhe nga Avokati i Popullit, ai bën një sugjerim në lidhje me pikën 3 të nenit 134 të projektligjit, ku parashikohet që punonjësve të strukturave speciale operationale t'u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtaritë operationale. Avokati i Popullit referon se ka pasur ankesa të personave të ndryshëm, të cilët kanë ngritur pretendimin që punonjës të këtyre strukturave kanë ushtruar dhunë fizike apo verbale në cenim të dinjitetit të tyre njerëzor. Në rastet kur prokuroria ka filluar hetimet, ajo është penguar për kryerjen e plotë të tyre, pasi policia nuk ka ndihmuar me dhënien e gjeneraliteteve të punonjësve të policisë të dyshuar për kryerjen e këtyre

veprave penale, me arsyetimin e ruajtjes së fshehtësisë dhe identitetit të punonjësve të këtyre strukturave. Avokati i Popullit sugjeron që të parashikohet shprehimisht në ligj: “Kur nga punonjësit e policisë së strukturave speciale operacionale, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre para ose pas operacionit kryhen vepra penale, ndaj tyre të ndiqen të njëjtat procedura ligjore, si dhe në rastin e shtetasve të tjerë”.

Së dyti “Drejtorja e Policisë së Shtetit duhet të vërë në dispozicion të organeve të drejtësisë personat dhe të gjithë dokumentacionin, me qëllim kryerjen e hetimeve”.

Së treti “Prokuroria dhe gjykata duhet të zbatojnë metodat dhe format ligjore të procedimit, të cilat garantojnë sekretin e klasifikuar policor, konform nenit 14 të ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001 “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”.

Duke qenë se në projektligj parashikohet nxjerrja e një sërë akteve nënligjore brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, si dhe për faktin se me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen tri ligje: “Për Policinë e Shtetit”, “Për Gardën e Republikës”, si dhe “Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit”, ne sugjerojmë se edhe afati i hyrjes në fuqi të këtij ligji të shtyhet me po aq kohë sa ju keni parashikuar për bërjen efektive të akteve nënligjore.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Felaj!

Pasi kemi dëgjuar edhe vlerësimin në tërësi në mbështetje të projektligjit nga relatorja, vazhdojmë me procedurën normale të komisionit, fillimisht me pyetje dhe më pas me diskutime.

U lutem kolegëve të jenë të vëmendshëm, duke respektuar përmbajtjen, qëllimin dhe rëndësinë e këtij projektligji, me qëllim që kur të bëjnë pyetjet e tyre në fokus të kenë projektligjin që kemi në shqyrtim. Gjithashtu, ju lutem, të evitojmë pyetjet nen për nen.

Ne tashmë kemi një procedurë të konsoliduar në komision, që në debatin nen për nen të ndalemi gjerësisht. Kështu që le t’ia lëmë atij debati pyetjet për çështjet që lidhen nen për nen dhe të qëndrojmë te pyetjet dhe debati në parim.

Kush ka pyetje?

Zoti Ristani ka pyetje.

Arben Ristani – Unë dua të bëj një qartësim, sa është pasur parasysh në ligj parimi i sigurisë juridike dhe i vazhdimësisë institucionale? Pra, siguria juridike, pavarësisht forcave politike që janë në pushtet, dhe vazhdimësia institucionale, pavarësisht këtyre, në projektligjin që keni sjellë. E kam fjalën sidomos për procesin e rikthimeve në polici. A është cenuar siguria juridike nga ky ligj në raport me ligjin që ishte? A është cenuar parimi i vazhdimësisë institucionale, pavarësisht forcave politike në pushtet, nga ky ligj në krahasim me ligjin e kaluar?

Fatmir Xhafaj - Zoti Ministër, keni fjalën.

Saimir Tahiri – Duke iu referuar pyetjes së parë, jo vetëm që respektohet plotësisht siguria juridike, por forcohet si nocion në këtë projektligj, në dallim nga ligji tjetër, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe standardet e përmbushjes së detyrës për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Arben Ristani – Po jua marr me shembull, në mënyrë që përgjigjja të mos jetë e përgjithshme. Unë iu referova rikthimeve në polici. Sipas nenit 47 ju thoni se rikthehen në polici vetëm ata të cilët janë larguar për shkak të shkurtimit të funksionit në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë. Kjo vetëm brenda dy vjetëve. Ky lloj përcaktimi është shumë më i kufizuar nga përcaktimet që kishte ligji i mëparshëm. Të gjitha rikthimet që kanë ndodhur praktikisht gjatë kohës suaj në Policinë e Shtetit, janë bërë sipas ligjit që ishte, që do të thotë kanë pasur një rregullim ligjor sipas ligjit që ishte për punonjësit e policisë që largohen nga policia. Tani ju e kufizoni jashtë mase, pasi vetë ju i keni bërë ripranimet. Për të ardhur te pika e 2, në momentin e rikthimit ju thoni se merrni një gradë më poshtë. Kështu ka qenë përcaktimi edhe në ligjin e mëparshëm, ndërkohë të gjithë ata që ju keni marrë, asnjëri nuk është marrë me një gradë më poshtë, por direkt me atë që ka vendi i punës. Në këtë vazhdë është edhe pyetja tjetër. Sa e zbaton ky ligj parimin e barazisë përpara ligjit të punonjësve të policisë? A janë të barabartë punonjësit e policisë, si ata që janë marrë deri tani, por edhe ata që do të merren nesër në Policinë e Shtetit mbi bazën e rikthimit? Për disa është vepruar ndryshe dhe për disa të tjerë do të veprohet ndryshe? A qëndron në këtë ligj barazia para ligjit apo jo?

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Ristani!

Do t'ju lutesha dhe do të bëj një ndërhyrje përpara se ta marrë fjalën ministri. Unë jam shumë i bindur se mund të rrimë me orë të tëra këtu dhe ministri me orë të tëra mund të japë përgjigje, por besoj se është në dobi të të gjithë kolegëve, nuk ka rëndësi të maxhorancës apo të opozitës, por është edhe në frymën e Rregullores dhe në traditën e punës së komisionit, që të fokusohemi jo nën për nën, se nën për nën do të bëjmë shqyrtimin. Bëni pyetje në parim dhe evitoni diskutimin, sepse do të keni mundësi në pikën tjetër, me qëllim që edhe ministri të jetë i fokusuar te përgjigja, që të evitojmë çdo lloj debati politik në këtë moment. Mendoj se na intereson të gjithëve ligji, sepse është mbështetje për policinë dhe garanci për qytetarët.

Arben Ristani – Ligji në vetvete në rast se nuk ndjek parimet e shtetit të së drejtës...

Fatmir Xhafaj – Bëni pyetje sesi ta bëjmë ligjin më të mirë, prandaj jemi në këtu.

Arben Ristani – Ky ligj ndjek parimin e sigurisë juridike apo jo?

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, secili deputet është i lirë ta bëjë pyetjen si të dëshirojë.

Zoti Ministër, ju lutem përgjigjet.

Kolegë, besoj se u kuptuam tani.

Saimir Tahiri - Faleminderit!

Besoj se dhashë përgjigje, por mund të jap përgjigje edhe më të detajuar meqenëse zoti deputet kishte pyetje më të detajuar.

E para, çfarë është bërë deri më sot është bërë duke respektuar ligjin në fuqi. Këtë gjë, ju më shumë se çdo njeri tjetër keni pasur rastin ta verifikoni nga gjetjet e komisionit hetimor, ashtu si secili nga ata ka pasur rastin t'i drejtohet gjykatës dhe ka dëshmuar me vendimin e gjykatës që ka marrë. Pra, kemi respektuar germë për germë dhe frymën e ligjit ekzistues “Për Policinë e Shtetit”, por ne vlerësojmë që Policia e Shtetit nuk mund të jetë depozita e njerëzve që ikin dhe vijnë, shkojnë bëjnë pushime dhe vijnë për cilëndo arsye. Ne vlerësojmë se në Policinë e Shtetit nuk duhet të rikthehesh më, në rast se shpërkëpesh prej saj 2 vjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, kolegë, ju lutem respektoni procedurën e komisionit dhe respektoni të drejtën e deputetit për të bërë pyetje dhe të drejtën e ministrit të japë përgjigje, siç e gjykon ai!

Ju lutem, mos ndërhyri kur flet ministri! Merreni fjalën sa herë të doni, të bëni pyetje dhe jam i bindur se aq herë ministri do t'ju kthejë përgjigje. Këtë detyrë ka ai, këtë të drejtë keni ju.

Zoti Ministër, ju lutem, vazhdoni!

Saimir Tahiri – Ne besojmë që të largohet për dy vjet rresht nga Policia e Shtetit, për cilëndo arsye, humbet çdo lloj kapaciteti që t'i rikthehet punës në Policinë e Shtetit në shërbim të qytetarëve, duke e konceptuar punën në Policinë e Shtetit si shërbim ndaj qytetarëve dhe jo si ofiq, as politik dhe as shoqëror.

E dyta, kjo është në vazhdim të garancive për të mos hequr më njerëz nga Policia e Shtetit. Në qoftë se nga njëra anë themi se ti nuk mund të kthehesh më në Policinë e Shtetit, nëse je larguar prej dy vjetësh, dhe nëse ke ndonjë merak, kjo gjë vlen edhe për ata që janë larguar në këtë kohë dhe ata që janë larguar në atë kohë, pra vlen për të gjithë.

Kjo është një garanci në vazhdim të sistemit të garancive që garanton ligji i ri për punonjësit e policisë në detyrë, që do të thotë se ky dy vjetësh mund të jetë edhe i tepërt, pra mund të mos hyjë fare në punë, mund ta lëmë edhe dy ditë, sepse në ligj nuk parashikohen klauzola për heqjen e punonjësve të Policisë së Shtetit, përveç rasteve kur shkelin ligjin për vepra penale, apo kur pakësohet limiti organik i vetë Policisë së Shtetit nga 9 mijë, bëhen 8 mijë. Nuk kanë pse hiqen më.

Kur nuk hiqen më, nuk ke përse të kesh merakun, nëse mbeten 2 vjet apo dy ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, ju lutem!

Zoti Ristani, e keni gabim!

Saimir Tahiri – Për sa u takon atyre që nuk e mbushin kohën dyvjeçare, pra rikthehen në polici brenda këtyre dy vjetëve, sigurisht që duhet të kenë një penalitet për shkak të kohës së humbur jo në detyrë, si edhe të aftësive të pakësuara për shkak të kohës së humbur, jo në ushtrimin e detyrës Ky penalitet është të rifutesh në Policinë e Shtetit me një gradë më pak. Ju nuk e respektoni këtë rregull dhe u jepni gradën sipas

pozicionit të punës, prandaj ka ndodhur që nga drejtor i shkollës bëhej drejtor i policisë, por nuk mund të jetë kjo Policia e Shtetit. Policia e Shtetit duhet të ketë rregulla të qarta karriere, bazuar mbi meritën, përkushtimin në detyrë, shërbimin ndaj qytetarëve dhe nuk mund të jetë një depozitë ku hyn e del sipas qejfit cilitdo. Ne duhet të shikojmë përpara me këtë ligj për të përcaktuar garancinë në detyrë, stabilitetin në detyrë, kapacitetin për të qenë i sigurt në detyrë duke pasur mendjen vetëm te përmbushja e detyrës, sepse ajo është rruga e vetme për karrierë, por nga ana tjetër, të garantojmë patundshmërinë në detyrë. Këto të gjitha garantohen duke përcaktuar, nga njëra anë pamundësinë për të hequr njerëz kot nga puna në Policinë e Shtetit, pra pamundësinë për t'i larguar punonjësit e Policisë për çdo lloj arsye tjetër përveç arsyeve që përcakton ligji dhe këto janë ngushtuar shumë, vetëm atëherë kur konsumon një vepër penale, sigurisht do të ikësh nga Policia e Shtetit, apo kur ikën me dëshirën tënde, por në këto raste, meqenëse garancia është kaq e madhe të mos largohesh nga detyra, kur largohesh nga detyra për më shumë se dy vjet, nuk mund të kthehesh përsëri në detyrë si aga dhe me të njëjtën gradë. Nuk mund të jetë kështu Policia e Shtetit. Ajo kërkon njerëz misionarë, sepse nuk është një punë dosido. Ajo kërkon njerëz që e besojnë shërbimin ndaj qytetarëve dhe që përkushtohen në maksimum ndaj qytetarëve dhe nuk mund të shkojnë dhe të bëjnë autostradë: hyr e dil sipas preferencave.

E dyta, çdo merak shumë i ngushtë që keni për ata njerëz që janë larguar deri më sot, ju garantoj që nuk gjen zgjidhje, sido që ta bëjmë këtë gjë, ta bëjmë dhe 10 vjet, sepse ata njerëz janë larguar nga detyra ose se kanë shkelur ligjin, ose janë punësuar nga ju në mënyrë të paligjshme, ose nuk kanë përmbushur detyrën. Kaq, është e thjeshtë. Pra, nuk ta zgjidh dot hallin asnjë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Ristani, ju lutem, se nuk keni vetëm ju pyetje.

Arben Ristani - Të mbaroj pyetjet e mia. Ju pyeta për vazhdimësi institucionale. Shteti shqiptar nuk fillon më 23 qershor 2013. Ka qenë edhe më përpara, prandaj kemi parimet e sigurisë juridike, vazhdimësi të institucioneve. Unë ju pyeta dhe duhet të më ktheni një përgjigje të plotë për këtë gjë, pa i ardhur rrotull me këto histori. Keni pranuar në Policinë e Shtetit, pa e zbatuar këtë nen, pa e ulur në gradë, kur rripranohen me dhjetëra persona. Ju sapo e thatë se kur largohesh për një kohë të gjatë humbet aftësia,

unë mund t'ju them se që nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe të tjerë me radhë kanë qenë të larguar për shumë vjet nga Policia e Shtetit dhe janë rikthyer.

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, bëni pyetjen!

Arben Ristani – Për mua, këtu shkelen dy parime, edhe siguria juridike edhe barazia para ligjit. Nuk mundet që një pjesë e njerëzve të trajtohen ndryshe dhe një pjesë tjetër ndryshe. Janë të barabartë para ligjit, pasi nuk mund të jenë disa të nënës dhe disa të njerksës. Dua një përgjigje të saktë për këtë pjesë.

Kam një pyetje të fundit dhe po e mbyll.

Lidhur me Byronë e Hetimit, kemi parimin e ndarjes së pushteteve, që funksionon në këtë demokraci të brishtë që kemi, por që mundohemi ta mbajmë, pra te ndarja e pushteteve drejtësinë e jep drejtësia, institucionet e drejtësisë. Sa respektohet ky parim te Byroja e Hetimit, që drejtësinë të mos e japë ekzekutivi, por drejtësia? A nënkupton shkelje të këtij parimi shprehja që drejtuesit e Byrosë së Hetimit përgjigjen para drejtorit të Policisë për veprimet procedurale dhe hetimore, që është dhënia e drejtësisë edhe para prokurorit?

Fatmir Xhafaj – Zoti Ristani mbaroi me pyetjet. Çështja e dytë ishte pyetje, por mbetet në çmimin tuaj për ta parë.

Zoti Ministër, ju lutem përgjigjet tuaja.

Saimir Tahiri - Zoti kryetar, unë vlerësoj se pyetjes së parë i dhashë përgjigje në mënyrë të përsëritur dhe jam gati të jap të njëjtën përgjigje, pavarësisht se nuk pres leksione të sigurisë juridike, për më tepër nga zotëria që bëri pyetjen, që, për hir të sigurisë juridike, fuste dorën edhe në kutitë e zgjedhjeve me sigurinë juridike, e para.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u shqetëso!

E dyta, ndarja e pushteteve respektohet plotësisht. Kjo është përgjigja ime.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Zoti Ministër desha të di, duke qenë se ligji më parë parashikonte se varësia e Policisë së Shtetit ishte nën Ministrinë e Brendshme cili është motivi i vënies së Policisë së Shtetit nën varësinë e ministrit? A keni ndopak shqetësim se

kjo gjë cenon parimin e paanshmërisë që duhet të ketë çdo institucion, por në mënyrë të veçantë Policia e Shtetit: paanshmërinë politike? Ju jeni funksion politik dhe jo më kot ligji e kishte bërë këtë lloj ndarjeje. A mund të më jepni një arsye për të kuptuar këtë gjë?

Më pas kam edhe një pyetje tjetër.

(Ndërprerje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, me thënë të drejtën ky është një debat që e kemi bërë.

(Zoti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Keni shumë të drejtë, megjithatë na intereson më shumë që opozita të bëjë pyetje sesa për mënyrën sesi e bën pyetjen. Jemi më të interesuar që opozita të bëjë pyetje dhe të marrë përgjigje sesa si e bëjnë pyetjen.

Po, zoti Ministër.

Saimir Tahiri – E para, Policia e Shtetit varet nga ligji dhe jo nga ministri, as nga ministria. Ky është parimi mbi të cilin është ndërtuar ky ligj në dallim nga ligji i kaluar që nuk varej as te ministri dhe as te ministria. Ministri në bazë të këtij ligji ka kompetenca strategjike të administrimit strategjik, planifikuese dhe monitoruese. Ligji bën një hap deciziv për ndarjen e Policisë së Shteti nga çdo lloj autoriteti politik. Bën një hap deciziv për depolitizimin e Policisë së Shtetit për evitimin e çdo ndikimi politik në Policinë e Shtetit dhe për depolicizimin e autoritetit politik në Ministrinë e Brendshme, që do të thotë se ky ligj jo vetëm përcakton se çfarë bën ministri si autoritet kushtetues (nuk është ministria autoritet kushtetues, por ministri) dhe çfarë bën Policia e Shtetit, por përcakton edhe çfarë nuk duhet të bëjë ministri, duke përcaktuar se ministri nuk mund të marrë pjesë, as të informohet, as të kërkojë informacion dhe as të bëhet pjesë e informacionit hetimor, e të dhënave operacionale, apo e aktivitetit dhe veprimtarisë operacionale dhe hetimore e Policisë së Shtetit. Ky është një hap përpara. Nuk kemi ndaluar këtu, por kemi shkuar shumë më përpara duke përcaktuar se asnjë punonjës policie i cilitdo niveli, jo vetëm që nuk mund të marrë pjesë në aktivitete politike, nuk mund të jetë anëtar, por as vetë fizikisht apo financiarisht, nuk mund të bëhet pjesë e cilitdo lloj aktiviteti politik., siç shikonim në zgjedhjet e kaluara punonjës policie me status dhe në *facebook*, apo që tundnin flamujt e partisë, jo vetëm duke marrë pjesë, por

edhe duke drejtuar fushata politike, por me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk do të ketë më. Kjo është ajo që garantojmë si standard në këtë ligj.

Oerd Bylykbashi - Po citoj: “Për më tepër varësia e policisë nga ministri bie në kundërshtim me parimin e paanësisë politike, në të cilin bazohet veprimtaria e policisë” sipas nenit 5 të projektligjit. Këtë gjë nuk e them unë, por prokurori i Përgjithshëm.

Zoti Ministër, ju përgënjeshtrojnë prokurori i Përgjithshëm me këtë që sapo thatë ju. Është vetë ai që ngre shqetësimin e cenimit të paanësisë politike në shkresën që ka dërguar sot. Shpresoj ta keni lexuar.

(Diskutime në sallë pa mikrofon.)

Zoti Ministër, unë e shoh zellin e madh që keni. Ju rishkruani një ligj të tërë pa pasur nevojën për ta bërë, por, duke qenë i bindur, sidomos në këtë çështje, ndërkohë që shteti ka Kodin Penal dhe të gjitha instrumentet që vijnë në vijim të tij, shtetasit nuk kanë gjë tjetër përveçse Kodin e Procedurës Penale për t’u mbrojtur edhe nga ministri që drejton ose ka në varësi policinë.

Si shpjegohet, ky është një shqetësim që jua ngre edhe prokurori i Përgjithshëm, që në mënyrë të rregullt ky ligj, në një rregullshmëri të çuditshme, shkon dhe konfliktin në mënyrë të hapur me një numër dispozitash në ligje të tjera me një hierarki më lart sesa ligji “Për Policinë e Shtetit”, për shembull, Kodin e Procedurës Penale, ligjin “Për Policinë Gjyqësore” e me radhë? Cila është arsyeja që ju i jepni në mënyrë të veçantë Byrosë Kombëtare të Hetimit kompetenca, të cilat qartazi shkojnë dhe dhunojnë dispozita që janë eprore karshi këtij ligji që na paraqisni ju sot, duke i dhënë të drejtë Policisë së Shtetit të ndërhyjë edhe aty ku e ka të ndaluar deri sot?

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, ju lutem, bëni pyetjen!

Oerd Bylykbashi – Cila është arsyeja pse ju keni bërë...

Kur të flasim nen për nen, do t’ia përmendim.

Fatmir Xhafaj – Bëjani pyetjen në parim.

Oerd Bylykbashi – Pse e keni bërë? Cili është qëllimi që ju, zoti Ministër, me këtë zell e vini Policinë e Shtetit, në mënyrë të veçantë Byrosë Kombëtare të Hetimit, jo thjesht në përplasje flagrante me legjislacionin epror, por që dhunon të drejta dhe liri individuale të shtetasve?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më pas, gjatë diskutimit nen për nen, do të flasim edhe për ato, por cili është qëllimi juaj politik?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ministër. Edhe unë jam dakord, se dua ta dëgjoj këtë, sepse kam një pikëpamje ndryshe nga kolegu. Për mua dispozitat që rregullojnë Byronë Kombëtare të Hetimit janë dispozita të ngushta. Do ta them më mbrapa, por, ju lutem, dëshiroj të di komentin tuaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Jua thotë edhe prokurori i Përgjithshëm, prandaj do të doja të kuptoja cili është qëllimi juaj.

Fatmir Xhafaj – Ju vetë e keni lexuar ligjin, apo lexoni atë çfarë thotë prokurori? Tani sa erdhi ligji. Lexojeni edhe vetë një herë ligjin.

(Deputeti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Por bën mirë ta lexoni vetë ligjin.

Saimir Tahiri – Nuk e di nëse keni bërë konsulta të veçanta me prokurorin e Përgjithshëm, por kjo është çështja juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë di që grupi i punës ka pasur një sërë prokurorësh pjesëmarrës në tavolinën e hartimit të këtij ligji. Në përfundim kemi bërë një konsultë finale. Prokurori i Përgjithshëm ka paraqitur edhe mendimet e tij finale, të cilat ne i kemi reflektuar në projektligj në përmasën që kemi menduar.

Ndoshta ju keni folur tjetër gjë me të, unë nuk e di, bisedoni...

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë, zotëri, po i referohem dokumentit...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka rëndësi. Bëtë pyetjen, dëgjoni përgjigjen tani!

Oerd Bylykbashi – ...në korrik. Kështu që mos bëni asnjë lloj aludimi tjetër.

Saimir Tahiri – Qetësohuni! Pse nuk qetësoheni?

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, ju lutem, ç'rëndësi ka? Ju e bëtë pyetjen siç deshët. Lëreni...

Oerd Bylykbashi – Prandaj, qëndrojeni përgjigjes. Më shpjegoni motivin tuaj politik në këtë reformë. Më shpjegoni pikërisht pse, për çfarë arsyeje ju shkon më larg sesa ju lejon legjislacioni në fuq.?

Saimir Tahiri – Mund ta vazhdoj përgjigjen pa pasur ndërprerjet tuaja, se unë nuk ju ndërpreva?

(Deputeti Bylykbashi ndërhyt pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, ju lutem, dëgjojeni! Mos bëni pyetje. Unë ju thashë, më mirë mos bëni pyetje, por ju nuk më dëgjuat.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Saimir Tahiri – Unë nuk e kuptoj pse jeni veçanërisht i shqetësuar për Byronë Kombëtare të Hetimit. Megjithatë, ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë edhe me ju, edhe me deputetët e tjerë të këtij komisioni, me Komisionin e Sigurisë dhe Kuvendin, për t'i dhënë Byrosë Kombëtare të Hetimit kapacitetin për të hetuar korrupsionin me jakë të bardhë dhe kollare, kriminalitetin që shkon deri në nivelet e larta, që ti e di shumë mirë...

(Deputeti Bylykbashi ndërhyt pa mikrofon.)

Dhe që nuk e kuptoj pse nuk doni që të jetë Byroja Kombëtare e Hetimit dhe të hetojë ata që korrumpojnë nivelet më të larta ose krimin e organizuar në nivelet më të larta.

Ju garantoj se, siç është e shprehur në germë dhe në frymë, por siç është edhe vullneti ynë, ligji nuk bie ndesh me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, por e mishëron dhe e materializon legjislacionin penal për ta bërë efektiv në mënyrë të atillë që njerëz me pushtet të vihen para drejtësisë për ngjarje kriminale, në qoftë se konsumojnë vepra të tilla, ose korrupsioni elitar të marrë fund njëherë e mirë. Ja, kjo është Byroja Kombëtare e Hetimit, që sigurisht do edhe suportin tuaj, do suportin e Kuvendit, kapacitete më të mira profesionale në parlament për ta pasuruar me të gjitha mundësitë dhe aspektet që i takojnë Byrosë Kombëtare të Hetimit nga pikëpamja ligjore dhe akteve nënligjore për të qenë realisht efektive në luftën kundër korrupsionit elitar dhe krimit të organizuar lidhur me të.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Oerd Bylykbashi – Kam edhe një pyetje të fundit.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni, vetëm pyetje, ju lutem. Pastaj keni të drejtë të diskutoni sa të doni.

Oerd Bylykbashi – Zoti Ministër, meqenëse u përpoqët të na mbushni mendjen se do ta luftoni korrupsionin në nivelet më të larta, kam një pyetje: duke qenë se Krimet e Rënda do të hetojnë vetëm pesë nga tridhjetë veprat e korrupsionit, se kështu u la nga parlamenti, duke mbajtur parasysh edhe atë që tha OPDAT-i, e ka të zezë mbi të bardhë, Byroja Kombëtare e Hetimit është një formë e centralizimit të hetimit, shkon përkundër standardeve demokratike të hetimit dhe çon në kontroll politik (e kanë thënë ata, nuk e kam thënë unë) dhe, duke qenë se do të mbetet kompetenca e atyre që ne njohim rëndom, “taskforca kundër korrupsionit”, si e siguron ju se kjo që ju thatë se këta do të bëjnë gjithë suksesin e luftës nuk do të hyjë... Duke pasur parasysh problemet që ngrihen, u ngrit edhe nga kolegja këtu, nga prokurori i Përgjithshëm, si e garantoni ju se nuk do të ketë konflikt kompetencash e për rrjedhojë dështim të luftës kundër korrupsionit si në nivelin poshtë, pra të 25 veprat me karakter më të ulët (me rrezikshmëri më të ulët), si për ato pesë veprat në nivelin lart, gjithmonë duke pasur parasysh që ju do të jeni nën hyqmin e prokurorit dhe nuk mund ta bëni ashtu siç mendoni ju vetë? ju lutem, ma garantoni ju. Si e shpjegoni mundësinë e përplasjes? Si do ta shmangni mundësinë e përplasjes midis dy organeve?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Saimir Tahiri – E kishit përgjigjen brenda pyetjes, zotëri, por ndoshta...

Oerd Bylykbashi – Desha përgjigjen tuaj.

Saimir Tahiri – Po të heshtësh, ndoshta e merr edhe përgjigjen time.

Ajo që thatë, siç është e shkruar edhe në ligj, garanton në mënyrë absolute mundësinë eventuale që të ketë konflikt kompetencash. Hetimet i udhëheq prokurori. Në qoftë se prokurori konfliktohet me veten, kjo është një gjë që nuk e shpëtojmë dot me ligj.

Për fatin e taskforcës nuk duhet të më pyesësh mua, duhet të pyesësh prokurorin e Përgjithshëm. Unë di t’ju them se për t’i ardhur në ndihmë luftës kundër kriminalitetit elitare, korrupsionit elitare, është e nevojshme...

Byroja Kombëtare e Hetimit nuk është centralizim, por është krijimi i një strukture të posaçme me kapacitete profesionale të posaçme, me mjete të posaçme

hetimore, që do t'i vijë në ndihmë edhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda për të hetuar veprat penale të cilat parashikohen.

(Deputeti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Ju lutem shumë, lexojeni ligjin...

Oerd Bylykbashi – Kujt tjetër përveç...

Saimir Tahiri – Ajo që keni përpara në tavolinë është shumë e qartë. Sugjerimet e prokurorit jemi të gatshëm t'i shohim bashkërisht, por mund t'ju garantoj se lufta kundër korrupsionit elitar dhe krimit të organizuar ka nevojë edhe për vullnetin tuaj.

Në qoftë se ju i shihni qeverinë dhe maxhorancën si armiq politikë deri në atë pikë sa edhe në luftën kundër krimit të mbani anën e krimit, kjo nuk është çështje që mund të zgjidhet me ligj dhe nuk zgjidhet me asnjë kuadër ligjor.

Në qoftë se ju e bëni të qartë si drita e diellit se keni vullnetin të bëheni njësh me maxhorancën, pse jo edhe me qeverinë, që të luftoni krimin dhe korrupsionin elitar, atëherë bujrrëm ta rregullojmë ligjin. Nuk kam asnjë problem, por thoni këtë në fillim që, po, mbështesni Policinë e Shtetit; po, mbështesni edhe Byronë Kombëtare të Hetimit; po, mbështesni luftën kundër krimit të organizuar; po, mbështesni luftën kundër krimit. Pastaj, mirë se të vini në tavolinë për të diskutuar bashkërisht si të arrijmë më mirë rezultate kundër këtyre.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Një vërejtje kam tani përpara se ...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Oerd Bylykbashi – Zoti Ministër apo kushdo qoftë nuk mund t'i thotë asnjë deputeti të opozitës ose të maxhorancës: “Nëse ju heshtni...”

Fjalën “hesht”, zoti Ministër, nuk mund ta lejojmë ta përsërisësh më në këtë komision.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Diskutime në sallë.)

Oerd Bylykbashi – Po e them edhe një herë, nuk mund të thotë “Hesht”, sepse është në shtëpinë tonë dhe nuk mund të japë urdhra në komision.

Fatmir Xhafaj – Mos e merr...

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Mos e përsërit herë tjetër!

(Diskutime në sallë.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Oerd Bylykbashi – Bashkim, e kam edhe për ty, mund të të kthehet ty nesër!

(Diskutime në sallë.)

Oerd Bylykbashi – Ka ardhur si ministër.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, do t’ju lutesha të mbani qetësi. Ta trajtojmë me qetësi.

Oerd Bylykbashi – Është një vërejtje ndaj ministrit.

Fatmir Xhafaj – Ministri ka qenë shumë korrekt në përgjigjet e tij, madje është provokuar nga ana juaj dhe e kolegut tuaj. Ai ka qenë korrekt në mënyrën siç e çmon të japë përgjigje. Nëse nuk dëshironi t’i bëni pyetje, mos i bëni pyetje, se nuk do të merrni përgjigje.

(Deputeti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – ...respektoni parlamentin.

Fatmir Xhafaj – Mirë.

Për respekt edhe të kolegëve, se ju përmendët opinionin e prokurorit të Përgjithshëm, çfarë ka thënë prokurori i Përgjithshëm? Që ka nevojë për ndryshime, shtesa dhe redakte. Ia kemi kërkuar ne, komisioni. Nuk ia keni kërkuar ju. Unë, në cilësinë e kryetarit të komisionit u kam kërkuar prokurorit të Përgjithshëm, Avokatit të Popullit, OPDAT-it, të gjitha institucioneve që të shprehen.

(Deputeti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Ligji ka 244 nene. Për 16 prej tyre prokurori i Përgjithshëm ka thënë: ka mendime për rregullime, për redakte.

Po, mirë, mor zotëri...

Oerd Bylykbashi – Të flet haptazi për norma...

(Deputeti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Prokurori është një institucion. Kuvendi është një pushtet. Dakord?

Oerd Bylykbashi – Sigurisht.

Fatmir Xhafaj – Edhe prokurori...

(Deputeti Bylykbashi ndërhyt pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – ...Kuvendi e miratoi dhe pastaj doli antikushtetues.

Fatmir Xhafaj – Mirë, meqenëse po më thua këtë, do të të them një gjë. Të lutem, kam një merak, se e bëtë zakon tani. Bëni pyetje, thoni ndonjë llaf dhe ikni. Ju lutem shumë, kur të vijmë te diskutimet, hajde jepni edhe ndonjë kontribut, dreqi e mori, që të jeni edhe ju në faqet e këtij ligji.

Oerd Bylykbashi – Zoti Xhafaj, bëni edhe pyetjet tuaja, drejtoni edhe komisionin...

Fatmir Xhafaj – Mirë, dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk ka gjë, e bëjmë vetë ne. E kemi bërë mirë këtë punë, por, ju lutem, bëni edhe ju ndonjë punë këtu.

(Deputeti Bylykbashi ndërhyt pa mikrofon.)

Ka pyetje të tjera? Zoti Lutaj, kishit pyetje?

(Deputeti Lutaj flet pa mikrofon.)

Po, zoti Islami për pyetje.

Kastriot Islami – Kam një pyetje për punonjësit që trajtohen me këtë ligj. Ka pasur ushtarakë të liruar në periudhën 2005-2006, do të ketë ushtarakë të liruar gjatë kësaj periudhe, ka pasur dhe do të ketë ushtarakë të liruar në kuptimin e ligjit edhe me këtë ligj në rastet kur parashikohet nga ligji.

Oerd Bylykbashi – Oficerë policie.

Kastriot Islami – Tregohen edhe rastet kur një oficer policie ose një punonjës i trajtuar sipas këtij ligji do të lirohet dhe pas kësaj ka edhe trajtimin përkatës.

Për ta kuptuar, të gjithë ata që lirohen para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, me sa kuptoj unë, trajtohen me ligjin e vitit 2009. Pyetja e parë është kjo: është kështu, apo jo?

Pyetja e dytë, në qoftë se këta të tjerët, që quhen ushtarakë ose ish-ushtarakë të liruar, trajtohen me ligjin e vitit 2009, kurse të gjithë të tjerët me të vitit 2014, a ka një mungesë homogjeniteti në trajtimin e këtyre, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Islami!

Fjalën e ka zoti Ministër për dy pyetjet e kolegut Islami.

Saimir Tahiri – Besoj se i dhashë përgjigje pyetjes. Ky ligj ngre në mënyrë të dukshme standardet e garancisë për ushtrimin e detyrës së punonjësit të policisë në shërbim të qytetarëve, për të garantuar siguri dhe rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Me qëllim që kjo të arrihet mirë, duhet të përcaktohet se kriteret e vetme për të bërë karrierë janë: merita, përkushtimi në detyrë dhe rezultatet në punë.

Kjo është fryma e ligjit, fryma e dispozitave në ligj dhe kjo është përgjigja ime.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Keni pyetje tjetër?

Po, urdhëroni.

Kastriot Islami – Ndoshta pyetja ime nuk u kuptua.

Pyetja ime ishte teknike, as politike dhe as provokim politik. Ka një grup ushtarakësh të liruar, e përsëris, në periudhën 2005-2006 dhe deri sot. Shumica e tyre, për shkak të një trajtimi që është bërë gjatë lirim të tyre, sorollaten nëpër gjykata (ligji i vitit 2007, i vitit 2009, vendimet e Gjykatës Kushtetuese e kështu me radhë). Dua thjesht një përgjigje: do të vazhdojnë të trajtohen në këtë mënyrë? Me sa kuptohet, nga neni 142 do të vazhdojnë të trajtohen në këtë mënyrë. Ndërkohë, kushdo tjetër, i rekrutuar (siç thoni ju) në bazë të meritës, të aftësive, të kontributit, të përkushtimit e të tjera, edhe mund të lirohet, por ka një mënyrë të caktuar se si trajtohet me ligjin e vitit 2014, i cili është i ndryshëm nga ai që trajton çdo person tjetër para kësaj date.

Unë vetë e kam një opinion, por doja t'ju pyesja ju më tepër, sepse të gjithë këta që janë liruar pyesin: do të trajtohem edhe ne njësoj, apo jo? Pra, a ka barazi në trajtim, pavarësisht se kur janë liruar? Sepse kush është liruar për shkak të dënimit, do të vuajë dënimin, por kush mund të jetë liruar qoftë edhe sipas ligjit, do të dijë nëse do të trajtohet nga pikëpamja financiare njësoj si këta që lirohen sot përsëri sipas ligjit?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni koment, zoti Ministër?

Saimir Tahiri – Nuk e di nëse jam i qartë, por, me sa kuptoj nga pyetja, bëhet fjalë për ushtarakët. Ky ligj nuk trajton ushtarakët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka kohë që Policia e Shtetit nuk ka status ushtaraku, madje ka shumë vite. Megjithatë, vlen parimi i sigurisë juridike që të gjithë kemi merak, që marrëdhënia juridike e kohës trajtohet me legjislacionin e kohës. Nuk e di sa përshtatet si përgjigje për ju, por...

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po, zonja Caka.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, kam dy pyetje.

Së pari, cili ka qenë modeli që keni marrë si referencë për krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit?

Së dyti, pavarësisht se shqetësimi im, në fakt, është i njëjtë me atë të relatores, personalisht kam frikën se kjo Byro do të ketë përplasje kompetencash me disa organe shumë të rëndësishme të pushtetit qendror. Njëkohësisht, do të doja t’ju pyesja ju, zoti Ministër, personalisht, a nuk mendoni se kjo Byro do të duhej të funksiononte në një nivel më të lartë, pasi në shembujt që kemi parë në të gjitha shtetet e botës kjo byro është kryesisht në varësi të strukturave më të larta të shtetit, kryesisht ose të Presidentit, ose të Kryeministrit?

Mua më krijon përshtypjen se kjo byro është në varësi të drejtuesit të Policisë së Shtetit e ndoshta as të ministrit. Ju si mendoni, do të duhej të funksiononte në një nivel më të lartë se kaq?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

Cili është komenti juaj, zoti Ministër, për dy ndërhyrjet e koleges Caka?

Saimir Tahiri – Nuk e di, ndoshta është përshtypje paraprake, por unë jam gati ta shohim nen për nen, ku ju mendoni se kjo strukturë konfliktkon me struktura të tjera. Për sa kohë kjo strukturë zbaton Kodin Penal dhe atë Procedural Penal, nuk ka sesi të konfliktohet me strukturë tjetër, flas teknikisht. Megjithatë, në rast se do të ketë nevojë për ta parë, këtë do ta shohim nen për nen.

E dyta, modelet që janë marrë parasysh për Byronë Kombëtare të Hetimit janë disa, kryesisht, europiane. Besoj ju e keni parasysh, por në parastresën që bëtë, nuk ishte tamam, Byronë Federale të Hetimit në Amerikë... Nuk përshtatet dhe nuk përputhet as në

funksion, as në strukturë dhe as në qëllim me vendin dhe funksionin policor që ka Policia e Shtetit.

Në rastin konkret, ka disa modele, por asnjë model nuk shkon deri te Kryeministri dhe as te ministri, për sa kohë janë autoritete politike, të cilat nuk mund të kenë edhe tagrin për të drejtuar struktura që zhvillojnë hetime të tilla lidhur me veprimtari kriminale, korrupsionin e kështu me radhë. Pra, është një funksion thelbësisht policor, që nuk mund t'i varet asnjë autoriteti politik, të cilitdo niveli. Të gjitha modelet që kemi parë kanë qenë ngushtësisht të sistemuara në strukturën policore normale. Ajo që e bën të veçantë është kapaciteti për ta përdorur. Pra, misioni, fusha e veprave penale që merr përsipër për të zhvilluar veprimtari hetimore, mjetet e hetimit, qëndërzimi në strukturën e shtrirjes në territor dhe natyra e veprave penale që merr përsipër të adresojë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Në radhë të parë, më lejoni t'ju falënderoj për ligjin që keni sjellë dhe për cilësinë e shkrimit të ligjit, qoftë të ligjeve që kemi kaluar dje, por sidomos të ligjit që kemi ne sot. Pa dyshim që nen për nen unë do të kem ndonjë koment të vogël, por do të vlerësoj maksimalisht kreun 9 të këtij ligji për marrëdhëniet e punës dhe trajtimin e personelit të policisë. Nuk kam fjalë të shtoj ose të heq. Ju komplimentoj për këtë rregullim kaq perfekt që u keni bërë të gjitha aspektet e jetës së punonjësve të policisë. Kam një pyetje. Në këtë kuadër për rikthimin në polici keni vënë një kusht ku thoni vetëm 2 vjetët e fundit. Rikthehen në polici vetëm ata që janë larguar nga ky shërbim 2 vjetët e fundit dhe janë hequr për shkak të shkurtimit të funksionit. Ku e keni bazuar këtë afat kohor 2 vjet?

E dyta, për drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ju thoni se ai do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 4-vjeçare plus një periudhë 5 plus 3 baras me 8, ndërkohë që zëdhënësi është më shkurt. Dhe pastaj nuk ka të drejtë të rikthehet në Policinë e Shtetit. Është menduar që ai po të jetë për shembull një 40-vjeçar, 48 vjeç do të

dalë në pension apo do t'i mundësohet t'i jepet një alternativë tjetër, se ai mund të jetë një personalitet specialist në këtë fushë, në profesion?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ministër.

Sajmir Tahiri - Faleminderit!

Unë u përgjigja, megjithatë e kam për nder t'ju përgjigjem përsëri. Lidhur me afatin 2-vjeçar. Nuk janë 2 vjetët e fundit, ky është një korrigjim, por bëhet fjalë se kush largohet nga Policia e Shtetit dhe jashtë Policisë së Shtetit shpenzon 2 vjetët e jetës së tij nuk mund të kthehet më në detyrë në Policinë e Shtetit. Për hir të së vërtetës me partnerët e PAMECA-s dhe ICITAP-it e kemi pasur afatin në mos gaboj 3 vjet dhe me sugjerimin e tyre u shkurtua akoma, sepse të gjithë vlerësojnë se kur ikën nga Policia e Shtetit, nuk mund të kthehesh, se nuk është si punët e tjera. Policia e Shtetit, e thashë dhe pak më parë, kërkon shpirt misionari për të bërë detyrën në shërbim të popullit, në luftë kundër krimit. Dhe ndaj shkëputja me më shumë se dy vjet nuk mund të të autorizojë të kthehesh prapë në polici, a thua se është një punë që mund të shkosh dhe të vish dhe ta marrësh me kollajllëkun që mund të marrësh punë të tjera. Jo, nuk mund të jetë kështu. Dhe kjo është bërë për të garantuar, pra bashkë me sistemin tjetër të garancive të parashikuara në ligj, kjo është bërë për të garantuar që punonjësi i Policisë së Shtetit e di shumë mirë që ka vetëm një rrugë për të bërë karrierë dhe e di shumë mirë që nuk mund të bëjë pushime nga Policia e Shtetit dhe të kthehet prapë, sepse ajo është rruga e tij e përcaktuar me vitet e jetës që ka konsumuar në punë në Policinë e Shtetit. E para.

E dyta, për sa i takon pyetjes tjetër, ne mendojmë se drejtori i Policisë së Shtetit, nuk do të jetë më drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, duhet të ketë një mandat në detyrë, mandat pas të cilit nuk mund të kthehet më në asnjë pozicion në Policinë e Shtetit. Është autoriteti më i lartë në Policinë e Shtetit, nuk mund të rikthehet në detyrë pasi përfundon këtë mandat dhe të bëhet vartës i pasuesit të tij. Është si të gjej një krahasim. Presidenti i Republikës të mbarojë mandatin dhe të shkojë të bëhet këshilltar i Presidentit tjetër. Akademinë nuk e kemi përjashtuar, ligji nuk e përjashton. Ne flasim nuk mund të kthehet në polici. Akademia është tjetër gjë. Dhe do të ishte e mirëpritur që drejtori i policisë të jepte kontributin e tij në Akademinë e Policisë për të formuar brezat që vijnë,

por jo të kthehet në shërbim aktiv në Policinë e Shtetit. Është kjo arsyeja dhe logjika e ndryshimit që kemi sjellë në ligj.

Për sa i takon moshës, nuk llogarisim që të jetë 40 vjeç drejtor i Policisë së Shtetit. Duke llogaritur vitet në karrierë për secilën gradë nuk mund të jetë kurrë drejtor policie 40 vjeç, plus kriteret e tjera të parashikuara në ligj. Pra, mendohet se kur bëhesh drejtor i Policisë së Shtetit nuk ke më karrierë aktive operacionale në struktura të tjera të luftës kundër krimit në Policinë e Shtetit. Mendohet se e ke mbyllur aktivitetin operacional ose menaxherial operacional në Policinë e Shtetit dhe je i gatshëm që eksperiencën në polici dhe në të gjitha nivelet dhe më së fundi në nivelin e lartë të menaxhimit si drejtor i policisë ta shndërrosh në bagazh njohurie për ta ndarë me brezat e rinj të punonjësve të Policisë së Shtetit në Akademinë e Policisë.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Unë kam dy gjëra që dua t'i sqaroj, zoti Ministër. Pavarësisht se dhe unë ndaj të njëjtin vlerësim me kolegët që ligji është i mirë në tërësinë e tij, ia ka arritur qëllimit për të cilin është për t'u pasur parasysh në iniciativën e ndërmarrë dhe nga pikëpamja teknikës legislative, me sa duket në këtë rast do të kemi më pak punë, duhet të sqaroj dy momente. Në nenin 21 dhe në përgjithësi në përmbajtjen e strukturave të policisë dhe në përbërje të këtij ligji ju vendosni strukturën e ruajtjes së personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë duke nënkuptuar kështu, siç thoni dhe në fund, me shfuqizime përkatëse, heqjen e Gardës së Republikës. Për një moment sikur të mendojmë që do të jetë kështu siç thoni, të ndajmë të njëjtin mendim, kështu siç e ka sjellë Këshilli i Ministrave, pyetja ime është : Vetëm një nen te ky ligj a i ezauron të gjitha ato funksione, ato përgjegjësi, ato detyra specifike që ka ky lloj shërbimi dhe që ligji ekzistues i mirësqaronte, pavarësisht nga devijancat që mund të ketë pasur në zbatimin në praktikë? Kjo është një gjë tjetër. Ne po flasim për ligjin. Duke mbajtur parasysh që kjo është një strukturë shumë specifike me shumë përgjegjësi specifike dhe me rregullime specifike të marrëdhënieve që ajo ka, një nen i vetëm në këtë ligj kështu siç është, a e rregullon dot? A mund ta rregullojë këtë duke mbajtur parasysh funksionin e tyre, misionin e këtyre strukturave.

Dhe e dyta, duke mbajtur në konsideratë praktikatat e mëparshme, a nuk ju duket se përqendrimi i policisë dhe i Gardës së Republikës, pra i ruajtjes së personaliteteve,

objekteve të rëndësishme të veçantë, ruajtjes së rendit në një dorë, siç është drejtori i Policisë së Shtetit, mund të krijojë probleme në raste situatash të veçanta, ndërkohë që qenia nën varësinë e ministrit, nën kontrollin e ministrit, do ta bënte jo pushtetin e tij më të dobët, por përqendrimin e pushteteve dhe ruajtjen e ekuilibrave brenda strukturave? Dhe në funksion të kësaj, nuk e di nëse keni pasur parasysh ndonjë model konkret apo ky është një rregullim specifik që ne mendojmë se duhet bërë?

Çështja e dytë që dua të sqaroj që trajtoi dhe relatorja dhe që besoj se u trajtua gjerësisht dhe nga ana juaj, që të jem korrekt, ka të bëjë me byronë kombëtare të hetimit. E them këtë dhe për një arsye fare të thjeshtë, sepse kjo është një çështje që ne si Komisioni i Ligjeve do të duhet të kemi vëmendje më shumë për ta trajtuar sesa aspekte të tjera të ligjit që janë më shumë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Komisionit të Sigurisë. Shqetësimi im është ajo çfarë ju keni dashur të realizoni me këtë strukturë, me 8 nene që keni vënë aty dhe duke mbajtur parasysh që nuk ndryshoni Kodin e Procedurës Penale vazhdoni të ruani të njëjtën shpërndarje të policisë gjyqësore. Nuk e zgjidh problemin e policisë gjyqësore kjo. Nuk zgjidh shumë gjëra që kanë të bëjnë me kompetencat e Policisë Gjyqësore për sa kohë që një pjesë e tyre mirë rregullohen te Kodi i Procedurës Penale në një mënyrë tjetër. A është e mjaftueshme dhe a jemi përpara një fakti që jemi duke krijuar një strukturë me një emër tjetër, por në fakt mund të na prodhojë në të njëjtët kufij veprimi, të njëjtat produkte nga pikëpamja e efektivitetit të saj në raport me qëllimin shumë të mirë që qeveria, ministria që ju drejtoni ka pasur, kur e ka iniciuar këtë iniciativë? Pa hyrë pastaj tek çështjet konkrete që kanë të bëjnë me mënyrën se si do të vendoset kjo strukturë në raport me të gjithë policinë, në raport me ministrinë, në raport me ish-SHKB-në, në mënyrë të veçantë në raport me prokurorinë etj. Kjo është pak a shumë ajo që do të desha, një sqarim më të plotë nga ana juaj për këto dy çështje.

Faleminderit!

Sajmir Tahiri – Së pari, lidhur me pyetjen e parë, a zgjidhet vetëm me nenin 21 gjithë ajo që parashikohej në kuadrin ligjor të Gardës së Republikës. Ne nuk e mendojmë kështu. Ne mendojmë se ky vetë është një ligj kuadër që nuk përjashton që drejtorja specifike pra, drejtorja e ruajtjes së personaliteteve dhe objekteve të rëndësishme të veçantë të rregullohet me kuadër ligjor tjetër. Sot ka një ligj për shembull për kufirin, ka një ligj për rendin, ka një ligj që sapo ka kaluar për ish- Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, gjë

që nuk përjashton që edhe kjo të rregullohet ose me akte nënligjore ose me një ligj të veçantë që do të ishte në këtë rast ligj për Drejtorinë e Ruajtjes së Personaliteteve dhe objekteve të rëndësisë së veçantë. Pra, për të qenë më konkret me përgjigjen time, ky nen sigurisht nuk e zgjidh, por ky është ligji kuadër që pastaj do të pasurohet me akte nënligjore, por edhe me akte ligjore të tjera të cilat rregullojnë pjesë specifike të veprimtarisë së Policisë së Shtetit aktualisht, por dhe në të ardhmen.

Për sa i takon varësisë, unë nuk besoj se kjo duhet parë e personalizuar në funksion qoftë me drejtorin e Policisë së Shtetit, qoftë me ministrin, në rastin konkret. Sot që flasim të dy edhe drejtori i Policisë së Shtetit dhe Komandanti i Gardës varet nga ministri i Brendshëm. Unë besoj që shton garanci në ushtrimin e detyrës, varësia ndaj një strukture apolitike siç është drejtori i policisë. Dhe nuk mendoj se është garanci, është shtuar varësia nga ministri i Brendshëm, pavarësisht që edhe struktura e varësisë së vetë drejtorisë së Ruajtjes së Personaliteteve dhe objekteve të rëndësisë së veçantë nuk e humbet kurrë kontaktin për shkak të natyrës specifike dhe kjo është thënë në ligj. Nuk e humbet kurrë kontaktin lidhur me detyrën që ushtron dhe me përgjegjësinë që ka ministri në këtë rast. Nuk jemi nisur nga situata konkrete, por sigurisht ka situata konkrete që të bëjnë të mendosh se Garda e Republikës e kishte shumë të lehtë të dilte jashtë misionit deri dhe të ekzekutonte 4 qytetarë të pafajshëm mes bulevardit.

Por nuk është ky motivi i vetëm për të sjellë këtë ndryshim. Të gjitha vendet, të cilat janë marrë model edhe në BE, kryesisht nuk kanë një gardë republike. As nuk ekziston. Ekziston sigurisht një drejtori për ruajtjen e personaliteteve dhe e objekteve të rëndësisë së veçantë, siç sot Policia e Shtetit ka një strukturë specifike për ruajtjen e objekteve. Sot që flasim, duke qenë të dyja institucionet të ndara, ka një strukturë në Policinë e Shtetit që është për ruajtjen e objekteve, ambasadat, rezidenca, e kështu me radhë. Dhe nuk ka asgjë të keqe që kjo strukturë e rregulluar me një legjislacion specifik për natyrën e veçantë të veprimtarisë që ka sot Garda e Republikës të ushtrojë funksionin që ne sot e kryejmë dhe që asgjë më shumë nuk bën Garda e Republikës sot.

Pra, nga pikëpamja e standardizimit rregullojmë me këtë ligj me më shumë garanci kuptohet për detyrën, me më shumë respekt për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, detyrën e asaj strukture shtetërore që duhet të kujdeset për sigurinë e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë që ne sot e

theksoj, policia e bën sot që flasim. Dhe nuk mendoj se varësia e të dyja strukturave t'i supozosh një do të ishte më e garantuar dhe më e sigurt në varësi të ministrit se sa të drejtorit të Policisë i cili ka qëndrueshmëri më shumë në detyrë, se ka një mandat të përcaktuar. Ka një kuadër ligjor specifik që rregullon dhe detyrën e tij dhe sjelljen e tij, normon sjelljen e tij dhe ka garanci dhe kufiza në veprimtarinë e tij lidhur me të gjitha strukturat e varësisë dhe me të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit në rastin eventual edhe të Drejtorisë së Ruajtjes së Personaliteteve.

Për sa i takon pyetjes së dytë për byronë kombëtare të hetimit, ju e thatë dhe pak më parë, e thatë dhe gjatë parashtresës së pyetjes tuaj, pamjaftueshmërinë e përcaktimeve ligjore në këtë ligj për byronë kombëtare të hetimit. Unë nuk do ta shihja kështu. Unë mendoj në kushtet që jemi. Kjo që kemi bërë me byronë kombëtare të hetimit është maksimumi për t'i dhënë një standard tjetër luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit elitar. Është e vërtetë që ka nevojë thuajse imediate për një reformë tërësore në të gjithë sistemin institucional të drejtësisë penale dhe të të gjithë mekanizmave të përfshirë. Por kjo gjë nuk mund të bëhet me këtë ligj dhe me këtë kuadër ligjor, pra me ligjin "Për Policinë e Shtetit". Ajo që ne kemi bërë sot është t'i përgjigjemi me sa kemi mundësi fushës së veprimtarisë deri diku të prokurorisë së krimeve të rënda dhe gjykatës së krimeve të rënda, jo plotësisht ndonëse. Dhe të ngremë një strukturë të specializuar në Policinë e Shtetit që do të jetë në gjendje në mënyrë të fokusuar tematikisht, pra nga pikëpamja e veprave penale dhe strukturalisht t'i përgjigjet sfidave imediate që kemi ne për luftën kundër korrupsionit që është një sfidë realisht e madhe, korrupsionit elitar dhe çdo veprimtarie kriminale të lidhur me të. Pa përjashtuar, u tha më duket këtu, veprimtari që lidhen me krime financiare në këtë fushë. E sigurt është që, në qoftë se do të bënim një ushtrim logjik dhe ligjor, mund të mendonim skema të tjera të funksionimit të byrosë kombëtare të hetimit duke përfshirë dhe një reformë në policinë gjyqësore, po të doni dhe në prokurori që sigurisht ka një nevojë imediate, por që nga ana tjetër nuk mund të zgjidhet dot me ligjin e Policisë së Shtetit. Domethënë ne e kemi të pamundur. Byroja kombëtare e hetimit do të duhet ta vërë veten në provë me këtë kuadër ligjor që është dhe me këtë strukturë të drejtësisë penale, por, nga ana tjetër, duhet të ndajmë bindjen që byroja kombëtare e hetimit duhet t'i shtohet edhe reformimit ligjor, në rast se sistemi

institucional i drejtësisë penale i nënshtrohet reformimit. Pra, nëse kjo ndodh, edhe byroja duhet t'i nënshtrohet reformimit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se këto do të jenë çështje, që personalisht do t'i trajtoj gjatë diskutimit nën për nen, por, gjithsesi, dëshiroja të dija vlerësimin tuaj si ministër, si titullar dhe si iniciues i projektit dhe përgjithësisht ndaj të njëjtin mendim me ju, se ka nevojë për një reformë tërësore, sepse pikëpamja ime është kështu siç është. Nuk është ajo që duhet të kishim.

Ka pyetje të tjera?

Zoti Braho, keni pyetje?

Urdhëroni!

Spartak Braho - Së pari, zoti Ministër, ju falënderoj për punën e mirë që keni bërë jo vetëm për ligjin e Policisë së Shtetit, por për tërë korpusin e ligjeve për të cilin është angazhuar dikasteri që ju drejtoni. Përgjithësisht, gjatë kësaj periudhene kemi analizuar dhe shqyrtuar me kujdes në komisionet përkatëse, veçanërisht, në Komisionin e Ligjeve dhe atë të Sigurisë dhe ky është një kontribut mjaft pozitiv, i pritur dhe i kërkuar prej shumë vitesh.

Ne kemi nevojë për reforma në të gjitha fushat, por veçanërisht në fushën e menaxhimit të Policisë së Shtetit dhe të aktivitetit që ajo kryen në të gjitha drejtimet. Nevojat janë imediate dhe të domosdoshme. Duke pasur si qëllim që edhe Komisioni i Ligjeve, edhe Komisioni i Sigurisë, edhe ne që jemi, pak a shumë juristë, kemi punuar prej vitesh me dëshirën për të ndikuar sadopak për t'i rregulluar këto gjëra, duke çmuar, ashtu siç tha edhe kryetari i komisionit, vërejtjet e domosdoshme, ku do të bëjmë edhe ndonjë pyetje, të cilën unë dua ta ndaj nga ngazëllimi i opozitës, që Spartak Braho po bën pyetje për të vënë ministrin përpara përgjegjësisë. Nuk është ky qëllimi im, por është për të ndihmuar dikasterin tuaj.

Pyetja e parë është që unë nuk arrij të kuptoj, me gjithë përgjigjen tuaj, përse e shkrini Gardën e Republikës?

Garda e shtetit ka 101 vjet. Nuk kam ndonjë nostalgji as për emrin Gardë, nuk kam as ndonjë nostalgji për gardën e qeverisë së Vlorës, apo për gardën e Zogut, apo për

gardën e Enver Hoxhës, apo për gardën e Sali Berishës. Kam respekt të veçantë për gardistët, sepse e di shumë mirë që kanë përballuar situata mjaftë rënda, madje edhe të rrezikshme, madje i kanë shërbyer, në radhë të parë, atdheut, por nuk më bind arsyeja përse shkrihet Garda?

Përse shkrihet kjo strukturë e posaçme (unë do ta gjykoja strukturë të posaçme), me një të rënë të lapsit? Domethënë ju vetë pranuat që nuk e shkrijmë, për shkak se kishim një gardë vrastare. Nuk është kjo. Ky është një banalitet, po ta gjykojmë tërë aktivitetin e gardës si gardë vrastare, dhe unë ju mirëkuptoj që nuk është kjo, por nuk arrij të kuptoj pse shkrihet?

Doni të bëni ndreqje strukturore? Unë jua them edhe nga përvoja ime, një gardist nuk bëhet kurrë polic. Gjenerali e di shumë mirë, një gardist nuk bëhet kurrë polic. Të tjera parametra ka gardisti, apo jo Piro, të tjera parametra dhe funksione, apo punim psikologjik ka polici.

Kështu që, me dy fjalë, do të doja të ma sqaronit edhe një herë këtë çështje. Unë do t'ju mbështes, sido që të vijë puna, edhe nëse keni ndarë mendjen për ta shkrirë, por jo pa marrë prej jush një arsyetim të plotë.

Kurse pyetja e dytë është: A jeni të hapur apo më mirë të themi, a ju vjen kontributi i komisioneve që do të shqyrtojnë për të bërë edhe ne ato rregullimet përkatëse? A jeni të hapur?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Saimir Tahiri – Nuk do të doja ta thosha as për shaka që nuk jemi të hapur. Sigurisht, jemi të hapur. Parlamenti është në të drejtën e vetë supreme që të bëjë çdo lloj vlerësimi lidhur me dispozitat e çdo ligji dhe në këtë rast është akoma më e vyer eksperiencia juaj, e Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Sigurisë në raport me legjislacionin dhe kuadrin ligjor që kemi sjell për miratim për reformimin e sektorit të sigurisë.

Lidhur me pyetjen e parë nuk besoj që argumentet duhet të mbeten vetëm te nostalgjia dhe historia e Gardës së Republikës, sepse nuk janë argumente të mjaftueshme argumentet nostalgjike apo historike.

E dyta, sipas Kushtetutës, në Republikën e Shqipërisë njihen dy statute: statusi policor dhe ushtarak. Nuk ka status hibrid, siç kishte garda dhe as nuk mund të ketë.

E treta, pikërisht me këtë status rregullojmë në mënyrë ligjore funksionimin dhe aktivitetin e Gardës së Republikës sot dhe nesër (uroj që të miratohet kështu), Drejtorisë së Ruajtjes së Personaliteteve dhe Objekteve të Rëndësisë së Veçantë.

Askund në ligj nuk thuhet që gardisti do të bëhet punonjës policie. Do të fitojë statusin, por nuk do të ushtrojë funksionin e punonjësit të policisë. Ja pse Drejtoria e Ruajtjes së Personaliteteve ka një specifikë edhe brenda Policisë së Shtetit. Vetëm për histori dhe nostalgji nuk mund të mbajmë një institucion, që nuk ekziston gjëkund. Unë besoj se e thatë edhe në emrin tim, që keni respekt për gardistët, edhe unë kam shumë respekt, por përcaktimet në ligj respektojnë më shumë vetë institucionin dhe të drejtat kushtetuese e ligjore të atyre njerëzve që sot punojnë prej shumë vitesh apo që nesër ndoshta do të rekrutohen në Drejtorinë e Ruajtjes së Personaliteteve dhe të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë.

Pra, shtojmë edhe respektin institucional dhe respektin njerëzor dhe statusin e veçantë që marrin me hyrjen në fuqi të këtij ligji për t'i dhënë fund, një herë e mirë, kaosit lidhur edhe me atë sektor dhe për ta rregulluar ligjërisht, në mënyrë që të garantojmë më mirë funksionin që ka vetë institucioni dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Qefalia, urdhëroni!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, në hyrjen e fjalës suaj thatë se hartimi i këtij drafti është bërë nga shumë ekspertë, specialistë dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit dhe prokuroria. Ndërkohë, sot pa filluar ende mbledhja, relatori dhe ekipi drejtues i komisionit janë njohur me një material të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme. Cili është mendimi juaj? Ka ndryshuar mendim..., sepse thatë se ka pasur përfaqësues edhe nga prokuroria kur është hartuar drafti. Apo ka ndodhur diçka tjetër?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Përpara se të përgjigjet ministri, unë e sqarova. Materiali që ka ardhur është një material që në tërësinë e tij është korrekt. Kanë bërë disa redakte,

ndryshime dhe plotësime, Avokati i Popullit dhe shoqatat. Kjo është një punë, që e bëjmë në çdo projektligj. Megjithatë ministri le të përgjigjet, por për mua nuk kemi pse t'i hyjmë kësaj, sepse ne nuk analizojmë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju keni shumë të drejtë për këtë pjesë, por sapo erdhi dhe...

Zoti Ministër, ju lutem!

Saimir Tahiri – Jo, nuk e kemi marrë si dokument. Gjithsesi, ky është shqyrtim parlamentar në Komisionin e Ligjit. Ne jemi të gatshëm dhe të hapur të marrin çdo gjë racionale që sjell jo vetëm prokurori i Përgjithshëm, por edhe Avokati i Popullit. Nuk ka qenë në fazën e hartimit të ligjit.

Dua t'ju garantoj se...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Qefalia, nuk kam faj unë, nuk mund t'jua zëvendësoj unë opozitën. Ju doni të bëni edhe maxhorancën, edhe opozitën, po nuk keni si...

Saimir Tahiri – Dua t'ju garantoj se Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, Ministria e Drejtësisë, OSBE-ja, ICITAP-i dhe PAMECA kanë qenë aktivisht të përfshira në hartimin e çdo dispozite. Pra, është ligj i bashkëhartuar me partnerët. Nuk është i konsultuar pas hartimit. Ndërkohë që ne mbetemi të hapur për çdo mendim tjetër.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Me kaq mbyllim pyetjet.

Vazhdojmë me diskutimet.

Kush e do fjalën?

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, sot kemi në shqyrtim këtë projektligj që në gjykimin tonë nuk sjell risi, por ka qëllime të tjera, që shqetësojnë këdo, jo vetëm ne si opozitë, por edhe kolegët e maxhorancës, të cilët ngritën një sërë pikëpyetjesh, të cilat nuk janë pak në peshën e tyre.

Sigurisht, në dukje të parë vihen re disa elemente që u ngritën më parë këtu. Ligji nuk respekton sigurinë juridike, e cila shkon përtej mandatesh politike, shkon përtej parimit të ligjit dhe të kohës. Parimi i sigurisë juridike është një parim shumë i

rëndësishëm. Qartas në këtë aspekt ka elemente, që synojnë të konsolidojnë vetëm qëndrimet politike të tanishme. Ju pastruat politikisht Policinë e Shtetit, i pretë kokën dhe i hoqët shtyllën kurrizore dhe sot doni t'i prisni rrugën çdo lloj mundësie që personat e larguar me pa të drejtë të rikthehen në Policinë e Shtetit.

Ju vetë me gojën tuaj, zoti Ministër, pranuat që personat, të cilët keni pranuar sot në Policinë e Shtetit nuk e kanë më kompetencën profesionale për të qenë në krye të Policisë së Shtetit duke filluar nga drejtori i Përgjithshëm. E thatë vetë.

Në këtë projektligj ne sot shikojmë një hakmarrje të verbër, ju e pranuat vetë, zoti Ministër që Garda e Republikës po goditet për hakmarrje politike. E pranuat me gojën tuaj. Thatë që është një nga arsyet, nuk e mohuat si arsye, dhe kjo është shumë e rëndë.

Nëse duhet të ketë Gardë të Republikës ose jo, është një çështje që fundja është në dorën tonë ta ndajmë këtu, të biem dakord me ju, ose jo, do të ketë diskutime në komision dhe në parlament, por nuk janë këto problemet më shqetësuese që ka projektligji juaj.

Kemi një projektligj që qartas kërkon ta vendosë nën zellin tuaj, kryesisht të Kryeministrit, dhe më pas të të gjithë kabinetit të tij të bindur e të maxhorancës, që ai mban nën kontroll, të një shteti policor. Qartas jemi përpara futjes së një fryme, që është e papranueshme në legjislacionin shqiptar, që deri më sot nuk ka qenë, të paktën në këta 24 vjetët e fundit.

Po kërkonti të krijoni një superpolici, e cila ka të drejtë të hyjë në të gjitha elementet, që janë të pacenueshme për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Kërkonti të hyni dhe të kontrolloni, të merrni nën kontroll jetën private të çdo qytetari. Sigurisht, nuk është vetëm kjo, është edhe VKM-ja me të cilën ju po kufizoni të drejta të tjera në lidhje me komunikimet e shtetasve shqiptarë, që është pjesë e kësaj pakete, pjesë e kësaj mendësie, por këtu nuk është çështje diskutimi.

Duke krijuar byronë kombëtare të hetimit ju thjesht po krijoni një instrument, i cili do t'ju bindet juve dhe me raste, kur ju ta mendoni, edhe Prokurorisë së Përgjithshme. E shkruani të zezën mbi të bardhë “edhe prokurorit” dhe kjo është një nga çështjet që prokurori ju godet dhe ju thotë: “Këtu po kapërceni parimet”.

Ky është një projektligj, i cili në shumë pika, sigurisht mund t'jua listojmë edhe ne, por për fatin e mirë të të gjithë neve, prokurori i Përgjithshëm, jo për çështje

redaktimi, zoti Ministër, por për çështje parimesh, ju thotë: “Po përplaseni me legjislacionin, që është një hierarki më e lartë se ky që kërkon t’ju bëjë juve të plotfuqishëm mbi liritë dhe të drejtat e shqiptarëve”.

Ky është problem që e ngritën edhe kolegët, me siguri do ta ngrenë edhe kur të diskutojmë nen për nen. Kjo është shumë e rëndë, sepse në momentin kur ju përplasni këtë ligj me ligje në hierarki më të lartë si Kodi i Procedurës Penale apo ligje të tjera, nuk jeni duke shkelur vetëm Kushtetutën, të njëjtën gjë që jua tha për aktin normativ pak kohë më parë edhe Gjykata Kushtetuese, më keq se kaq, ju jeni duke cenuar liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve. Sigurisht, ju këtë e kërkon, sepse një shtet policor nuk ekziston dot pa këtë. Në konceptin tuaj të Policisë së Shtetit nuk keni gjë, vetëm një koncept ...të policisë, por ne nuk mund ta pranojmë këtë.

Zelli juaj i fshehur nën petkun e luftës kundër krimit të organizuar, që në fakt nën flamurin tuaj ka gëluar në rrugët e Shqipërisë, jo më larg se 100 metra prej këtu kemi parë një gjë shumë të rëndë të gjithë ne shqiptarët, nën flamurin e luftës kundër korrupsionit për jakat e bardha në nivelet më të larta drejtuese, e kemi fjalën për ministrat e qeverisë, zakonisht për këta bëhet fjalë, me këtë super- institucion policor, i cili mund t’i shmanget edhe prokurorisë, do të hetoni kolegët tuaj, ose kjo polici mund t’ju hetojë edhe ju.

Në fakt, këto janë të gjitha gënjeshtra. Qëllimi i vetëm është një: vendosja një shteti policor, që shqiptarët të mos kenë mundësi të reagojnë kundër jush. Opozita, afërmendsh, nuk mund të jetë dakord kurrë me një propozim të tillë, jo thjesht sepse ky është një ligj, që nuk sjell risi në përmirësimin e Policisë së Shtetit, por më shumë se kaq, ky ligj dëmton rëndë konceptin e paanësisë politike të Policisë së Shtetit. Meqë ju e përmendët një shembull, në 10-vjeçarin e fundit ka dhënë provën që në momentin më delikat politik, që janë zgjedhjet, ka qenë një shembull në proceset zgjedhore. Sado që ju të gënjeni këtu, duke thënë se ka pasur policë, të cilët janë përfshirë në procesin zgjedhor, nuk ka prova, përkundrazi, është e kundërta. Kështu që, zoti Ministër, unë besoj se është mirë që ju këtë ligj ta merrni me vete, ta konspektoni, jam i sigurt që të paktën e keni në zyrën tuaj, edhe nëse nuk e keni lexuar, por gjykoj se nuk mundet që t’i sillni Parlamentit një ligj që cenon kaq rëndë parimet e shtetit të së drejtës, dhe mbi të gjitha, vë në rrezik liritë dhe të drejtat themelore të individëve.

Fatmir Xhafaj – Do të dëshiroja t’ju lexoj një gjë, në vëmendje të kolegëve, duke reflektuar kritikën e zotit Qefalia ndaj meje, që e pranoj, me thënë të drejtën, duhet ta kisha shpërndarë. PAMECA ka sjellë një shkresë këtu, e kam unë, do ta shpërndaj, e cila thotë: “PAMECA 4 ka asistuar nga afër dhe i ka dhënë këshillim dhe rekomandime Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe grupi përkatës i punës së krijuar, me qëllim hartimin e ligjit për Policinë e Shtetit shqiptar. Shprehim me kënaqësi falënderimin për bashkëpunimin e shkëlqyer të krijuar me Ministrinë e Brendshme gjatë procesit të hartimit të projektligjit në fjalë”, thotë PAMECA, nuk e them unë, do t’ju shpërndaj këtë.

Ndjesë, zoti Qefalia, unë duhet ta kisha bërë përpara.

Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Më fal, zoti Strazimiri ka kërkuar fjalën.

Gent Strazimiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni të citoj relacionin e ministrisë, i cili thotë se: “Projektligji për Policinë e Shtetit ka si qëllim të përcaktojë misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat, përgjegjësitë, kompetencat dhe statusin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rregullojë veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës, mirëqenien dhe vazhdimësinë në detyrë të punonjësve të policisë. Më tej, siç edhe ju e përmendët në letrën që ka sjellë PAMECA, thotë se ligji përmbush prioritetet kryesore dhe kriteret kryesore të përcaktuara nga KE-ja, janë bërë rekomandime me filanin, fistekun, dhe sigurisht me PAMECA-n, ICITAP-in dhe OSBE-në. Ky është ekzaktësisht relacioni i sjellë në këtë Kuvend në ligjin paraardhës, atë që po shfuqizojmë sot, dhe që po e shajmë sot, si një ligj me boshllëqe, si një ligj që nuk bën, si një ligj që ka sjellë deformime.

Është një ligj, ai paraardhësi, ndryshe nga ky, dhe për këtë dëshmoj, i cili është bërë me konsultën e PAMECA-s, ICITAP-it, OSBE-së etj., është shkruar nga PAMECA, ICITAP-i, OSBE-ja etj., me konsultën e specialistëve tanë, që do të thotë: nëse ligji paraardhës krijonte premisa për ndikim të politikës në Policinë e Shtetit, për marrje në mënyrë të paligjshme për persona që ishin të padenjë për Policinë e Shtetit, apo shkarkime të paligjshme, autorësia bie pikërisht mbi ata që kanë bërë ligjin. Sigurisht që

gjërat nuk qëndrojnë, e vetmja e pavërtetë në gjithë këtë konflikt thëniesh janë ato që tha ministri këtu. Ligji paraardhës ishte një hap shumë cilësor përpara, nuk do ta doja ta shaja ligjin aktual, sigurisht krijon struktura apo riorganizon struktura dhe misioni i Policisë së Shtetit mbetet po ai.

Në riorganizimin e strukturave, në suprimimin e disa strukturave dhe krijimin e disa strukturave dhe ca shpikjeve të tjera, ndryshe nga ligji paraardhës, është bindja ime se kjo nuk ndodh për shkak se duhet përmirësuar Policia e Shtetit dhe puna e saj, përkundrazi, bëhet, siç ju tha kolegu, Bylykbashi, qartësisht, hapur dhe pastër këtu, që Policia e Shtetit, ndryshe nga çfarë përcakton ligji paraardhës, të shkojë në vartësi direkte edhe në nivelin operacional të ministrit, sigurisht, jo në mënyrë deklarative, por duke vendosur në dorë të ministrit emërimin e personave që praktikisht kanë në dorë veprimtarinë operationale të Policisë së Shtetit.

Ministri tha në mënyrë të përsëritur këtu në fillim se ky projektligj përveç të tjerash na plotëson boshllëkun për vepra penale të paparashikuara, në të cilat policia gjente arsye të mos vepronte. Sado i kompletuar të jetë ky ligj, edhe sikur të mos i kishte këto që unë thashë, qytetarët, me kulturë juridike, qoftë edhe shumë të mangët, duhet të kuptojnë faktin që i vetmi ligj apo i vetmi dokument me një sistem ligjor që plotëson këtë boshllëk, është Kodi Penal, dhe sigurisht ky ligj “Për funksionimin e Policisë së Shtetit” nuk mund ta ketë këtë mision, dhe kjo është një broçkull tjetër që u tha këtu.

Për sa i përket suprimimit të Gardës së Republikës dhe kalimit të saj si një strukturë e veçantë mbrojtjeje personalitetesh dhe godinash qeveritare nën Policinë e Shtetit, unë, të them të drejtën, ndryshe nga disa kolegë parafolës, kam nostalgji për jetën 101-vjeçare të këtij institucioni, nuk mund të them se më lë indiferent shkrirja e Gardës së Republikës, por do të doja që në këtë diskutim të ndalesha te fakti dhe arsyeja për të cilën na paraqitet se po suprimohet Garda e Republikës. Garda e Republikës suprimohet si strukturë, në fakt misioni i saj mbetet, që do të thotë: ruajtja deri në vetëmohim, si në këto 101 vjet, e personaliteteve shtetërore, personaliteteve të larta, të huaja dhe të vendit, dhe godinave apo institucioneve shtetërore, që do të thotë se për të realizuar misionin e saj Garda e Republikës me ligj ka disa kompetenca, ka disa pajime dhe pajisje që nuk i ka polici i rrugës, ka një mision për t’u përmbushur deri në pikën e fundit të gjakut në momentin kur është në vendroje, që do të thotë se pavarësisht

se kjo strukturë kalon nën Policinë e Shtetit, nëse institucionet, personalitetet që kjo strukturë do të vazhdojë të ruajë, cenohen me dhunë në mënyrë të përsëritur, të organizuar dhe me qëllim djegien, shkatërrimin apo përmbysjen e rendit kushtetues, do të duhet të reagojë njësoj si Garda e Republikës, të cilën sot ne po suprimojmë. Kjo është detyra që ajo ka, kjo është arsyeja për të cilën ne e paguajmë. Kështu që edhe ky nuk është ndonjë ndryshim shumë thelbësor. Nëse ju kënaq, bëjeni!

Për sa i përket krijimit të byrosë së hetimit, nisur nga eksperiencia që unë kam pasur në drejtimin politik të Ministrisë së Brendshme, në fakt është një përzierje, besoj një instrument aspak inteligjent, por brutal, për të siguruar atë që e tha shumë mirë kolegu Bylykbashi, dorën e zgjatur të ministrit dhe të Kryeministrit në veprimtarinë operacionale të Policisë së Shtetit. Nuk sjell asgjë të re byroja e hetimit, përveç faktit që i merr ca kompetenca prokurorisë, por Departamenti i Hetimit të Krimit, që ka funksionuar deri sot në Policinë e Shtetit me gjithë drejtoritë dhe strukturat e tij operacionale, tashmë do të quhet byroja e hetimit. Ndryshe nga ligji paraardhës dhe garancitë që jepte në kuadrin operacional, duke e vendosur nëndrejtorin e përgjithshëm të policisë me një procedurë të qartë dhe të saktë për emërimin dhe shkarkimin e tij, sot emërohet nga ministri një person që ministrit do t'i pëlqejë, “mund të jetë, thotë, polic ose prokuror”, ndërkohë që e nxjerr krejt jashtë piramidës dhe logjikës së ecjes në gradë dhe në karrierë Policinë e Shtetit. “Mund të jetë një prokuror – thotë - që ka jo më pak se iks vite eksperiencë në hetimin e krimit” dhe nga momenti që emërohet, merr gradën “Drejtues i lartë”, më duket, do të thotë një nga gradat më madhore të Policisë së Shtetit, merr gradën “Drejtues i lartë” me ferman të ministrit, jo për shkak të karrierës, në një kohë që neni i mëposhtëm thotë: “Drejtori i byrosë së hetimit duhet t’u përgjigjet domosdoshmërisht këtyre kriterëve: të ketë gradën “Drejtues”, “Drejtues i parë”, që të mund të marrë gradën “Drejtues i lartë”. Nëse e merr nga prokuror, nuk mund ta ketë gradën “Drejtues”, “Drejtues i parë””.

Gjithsesi, kjo, për mendimin tim, tregon mënyrën sesi është tentuar që ky ligj të shartohet jo vetëm dhe thjesht për të përmirësuar punën në Policinë e Shtetit, por edhe për të mbajtur dorën e gjatë të ministrit dhe të fermanit që ai do të duhet të firmoste në momente të caktuara për të shtënë në dorë veprimtarinë operacionale të Policisë së Shtetit.

A është ky ligj më garantist? A mund të jenë më të qetë tani oficerët e policisë? Ligj më garantit se ai që kishim, nuk mund të ketë. Nga pikëpamja e garancive që ky ligj jep për karrierën dhe gradat, ecurinë në Policinë e Shtetit, është mot a mot si ligji i mëparshëm. Askush nuk pyeti për ligjin e mëparshëm. Oficerët e policisë që donin të shkarkonin, i shkarkuan, oficerët e policisë që donin t'i merrnin, i morën në punë. Hoqën disa oficerë policie me karrierë 15-18 –vjeçare, 20-25-vjeçare në Policinë e Shtetit, asnjëri prej tyre zyrtarisht për përfshirje në organizim kriminal apo për dekonspirim, të gjitha fjalë që i thotë vazhdimisht ministri, e ka pasur thënë edhe më përpara se të bëhej ministër, zyrtarisht nuk figuron, dhe këtë po jua them edhe nga raporti i Komisionit Hetimor të Policisë së Shtetit. 406 oficerë deri më datën 31 janar të shkarkuar, asnjëri prej tyre i proceduar penalisht, asnjëri prej tyre i akuzuar, as sot edhe në këto momente që flasim, për lidhje me krimin, për dekonspirim apo për paaftësi në punë. Do të thotë që ligji nga kjo pikëpamje është prapë në dorë të Maliqit, është më shumë, sepse tashmë varet nga Maliqi, dhe këtë Maliqi sapo e tha këtu.

Ministri thotë vazhdimisht: “Ne besojmë dhe ne vlerësojmë”. Unë nuk besoj se ministri i beson ato që thotë. Nëse do t'i besonte ato që thoshte, nuk do të kishte sjellë këtë ligj, dhe me besim në parimet që thotë, që një oficer policie, siç na tha, nëse për dy vjet nuk punon në organet e policisë, e paska të pamundur të riintegrohet me shpirtin e organizatës, sepse, siç tha, duhet të ketë shpirt misionari, duhet të jetë, gjithashtu, i depolitizuar, ndërkohë, akti i parë që ka bërë lidhur me këtë parim, është emërimi i Artan Didit në krye të Policisë së Shtetit, e ka marrë nga rruga, ose më saktë, nga komisioni i PS-së në të cilin numëroi votat, si të depolitizuar, është person i larguar nga Policia e Shtetit në vitin 2004, i akuzuar për lidhje me krimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund të flas, zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, e kisha me zonjën Hysi.

Gent Strazimiri – Me mikrofonin hapur, kam mendimin se më dëmton incizimin.

...Në vitin 2004 është person i shkarkuar nga SHKB-ja e drejtuar dhe që i përgjigjet një ministri socialist, jo një ministri të Sali Berishës, do të thotë që parimi nuk qëndron që në momentin që është emëruar drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Për të mos vazhduar pastaj me piramidën e oficerëve që janë zëvendësuar, janë të gjithë, dhe

ne i kemi denoncuar në konferenca për shtyp dhe në Parlament, me emër dhe me mbiemër, me dokumente shtetërore, që figurojnë financues të Partisë Socialiste në zgjedhje, që figurojnë numërues apo komisionerë të Partisë Socialiste në zgjedhje. Në qoftë se kjo ata i bën të depolitizuar, kjo është një logjikë që vetëm ky ministër mund ta ketë dhe çdo njeri që i shkon mbrapa bën gabimin më të madh, sepse njerëzit kanë sy dhe veshë, i dëgjojnë, kanë dhe mend të mendojnë.

Detyra më qesharake, që mendojnë se i vënë vetes me ligjin e ri dhe me krijimin e byrosë së hetimit është se do të na luftojë tani korrupsionin. Nuk e bën dot prokuroria, sepse ajo nuk varet nga Edi Rama, nuk e bën dot gjykata, sepse as ajo nuk varet akoma nga Edi Rama, madje as nga Nasipi, Nasipi po tund këmbët tani që të varet gjykata nga ai. Korrupsionin në këtë vend e bën vetëm qeveria, nga Kryeministri dhe secili prej ministrave. Asnjëri prej nesh që shikoni këtu, të nderuar qytetarë dhe gazetarë, nuk ka në dorë asgjë nga paratë tuaja. E vetmja gjë për të cilën ne firmosëm si deputetë këtu, është borderoja në të cilën na sjell përpara Ilir Meta dhe kjo listëprezenca, që na sjell Fatmir Xhafaj në komision, asnjë lek tjetër nga paratë tuaja ne nuk shpenzojmë dot. Ministrat dhe Kryeministri shpenzojnë, ata kanë mundësi të bëjnë korrupsion, asnjëri prej nesh jo. Tani, me këtë ligj ministri po ju thotë se duke e caktuar personin që do të hetojë korrupsionin, vetë Kryeministri dhe vetë ministri, korrupsion nuk do të ketë më. Domethënë, do të hetojnë vetveten nëpërmjet një personi të besuar, sigurisht i depolitizuar dhe i certifikuar si komisioner i PS-së, sigurisht i depolitizuar dhe i certifikuar si financues i PS-së.

Nëse të gjitha këto mendoni se janë një hap përpara dhe që sigurisht do të mbyllen me sloganin: “Jemi më mirë se një vit më parë”, shyqyr që shpëtuam, tha dikush këtu, nga qeverisja e mëparshme, atëherë, të paktën, në mënyrë shumë racionale, të suprimojmë disa institucione që i quajmë të pavarura, i kemi në Kushtetutë: gjykatën, prokurorinë, Presidentin e Republikës dhe çdo institucion tjetër që do të duhej normalisht të balanconte pushtetin e Kryeministrit dhe të ministrave, sepse, në fund të fundit, tani drejtësinë, policinë, gjykatën, prokurorinë, gjeneralët, komandën e ushtrisë e ka Kryeministri, të paktën kursejmë nga ky shtet një tufë me rroga jo të vogla.

Kështu që, të nderuar kolegë, nuk fshiheni dot duke sharë ligjin paraardhës, që e ka bërë PAMECA, ICITAP-i, e kanë bërë institucione shumë të rëndësishme

ndërkombëtare, e kanë certifikuar deri në rregulloren më të fundit që ka dalë në zbatim të tij. Nuk gënjeni dot duke thënë se policia nuk ka ndërhyrë në zgjedhje, e të tjera me radhë, sepse ka dalë Edi Rama në vitin 2009 për herë të parë në 23 vjet demokraci në Shqipëri dhe ka thënë: “Falënderoj Policinë e Shtetit për qëndrimin evropian që mbajti në zgjedhje”, dhe Kryeministër ishte Sali Berisha, ka funksionuar nën atë ligj që ju sot po suprimoni. Nuk ua mbushni dot mendjen njeriu që policia sot është më e pavarur, po them atyre 700 mijë vetave që nuk preferuan Edi Ramën për Kryeministër, që duke shkuar sot te komisionerët e PS-së, që janë bërë shefa komisaratesh, që janë bërë drejtorë të rëndësishëm në Policinë e Shtetit, do të gjejnë të drejtën e tyre.

Besoj se është një zullum shumë i madh që po bëni sot dhe besoj që do të ishte urimi im sot: “Zoti ju shtoftë inatin, se në këtë mënyrë, duke bërë të tilla zullume, edhe shqiptarët zgjohen më shpejt nga gjumi”.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka tjetër? Dakord.

Nuk ngelet gjë tjetër, vetëm të votojmë në parim.

Kush është dakord ne parim? Kundër? 3 veta kundër. Abstenim?

Miratohet projektligji në parim.

Faleminderit!

E mbyllim këtu mbledhjen e komisionit.

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj, që ishit së bashku me ministrin!

Faleminderit medias, që ishte e pranishme!

Faleminderit, kolegë!

Natën e mirë!